

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

85H-32

9.61

AHMET  
GOLEMI

TREGIME  
DHE SKICA

ELEKTRICISTI  
I TURNIT

891-983-32

q. 61.

AHMET GOLEMI

R

# ELEKTRICISTI I TURNIT

(Tregime dhe skica)

~~56271~~

34924

BIBLIOTEKA E SHETIT  
GJIROKASTER

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

duke bërë një rrugë me zigzage. Era e ftohtë, e furishme që na frynte përballë na e përplaste shiun në fytyrë. Atëhere na dukej sikur dikush na qëllonte me fije të holla kamzhiku.

— Mirë që po ngjitemi, por a do të ketë ndonjë vend të përshtatshëm për të vendosur çadrën? — pyeti Artani.

— Ka. Në majë ka — pohoi me ngulm Abazi, që vazhdonte të printe rrjeshtin tonë të shkurtër.

Artani dhe unë ngritëm supet. Përgjigjja e tij kaq e vendosur, padurimi i tij për të arritur majën sa më parë na çuditën.

Kishte kaluar një kohë e gjatë që po ecnim. Shpatullat na ishin qullur nga djersa aq sa na bëhej se shiu që binte na përshkonte mushamatë dhe na futej në trup. Kur mbërritëm atje mbetëm si të shtangur. Vendi ngjante me një dhomë të rrumbullakët pa çati. Dukeshin gjurmë të lëna nga njerëz që kishin jetuar kohë më parë. Gropa ishte punuar me kujdes. Dy gurë kishin mbetur ende në vendin ku qe ndezur zjarri. Përdhe qe rrëzuar një gavetë. Ajo qe gërryer nga shirat. Shiu filloi të pakësohej. Nga veriu shtriheshin male dhe vargmale të larta. Nga jugu poshtë male dhe pyje, dhe pak më tej Korabi që, si një babagjysh me gunën e bardhë shekullore në krah, hidhte vështrimin e rëndë përreth. Ndërkaq Abazi u ul ngadalë, preku lehtë me gishtërinj gurët, i lëmoi ato me përkëdhelësi posi kokat e dy fëmijëve, mori në duar gavetën, e mbajti gjatë atë si për t'i numruar gropëzat, e vuri sipër gurëve që ishin vendosur kastile për të, ndejti ca ashtu i menduar, dhe pastaj po me ngadalë u ngrit si për të kërkuar diçka rreth e

rrotull. Ai vuri në pëllëmbën e dorës së djathtë ca gëzhoja, që i gjeti në një anë, kurse me dorën tjetër i prekte ato lehtë, si për t'u hequr baltën dhe ndryshkun e zënë prej vitesh.

Artani dhe unë e vështronim përgjegjësin e grupit me kërsëri. Tani shiu kishte pushuar. Nga malet e larta përtej u ngrit një napë e bardhë mjegulle. Pas pak Abazi u afrua buzë gropës dhe si nga një post vrojtimi treti vështrimin poshtë.

Unë hapa shpejt çantën, nxora shishen dhe ja dhashë. Ai e mori, rrëkëlleu ca gllënka dhe ma dha përsëri mua, e unë Artanit.

— E more djema! Kalojnë vitet dhe koha qenka e pafuqishme për të na bërë që të harrojmë sadopak ngjarjet që kemi kaluar në ditët e stuhishme.

E kuptuam! Ishte e qartë që ky vend i sillte ndër mend ngjarje të jetuara vite më parë. E lutëm të na tregonte. Abazi ngriti dorën, e kaloi nëpër flokë dhe nisi tregimin:

«Atëhere që janar. Batalioni ynë kishte marrë urdhër nga shtabi i brigadës që të kryente një detyrë me rëndësi. Për këtë duhej të marshonim sa më shpejt të qe e mundur drejt veriut. Dhe kështu bëmë. Po hitlerianët, të sinjalizuar e të ndihmuar nga forcat e Ballit po na ndiqnin këmba-këmbës. Ata ishin shumë. Po ne s'e kishim hallin atje. Detyra jonë që të marshonim drejt veriut. Ndaj i shmangeshim ndeshjes me ta. Forcat e shumta armike mundën të na rrethonin në brendësi të pyllit me ahe të motshëm. Atëhere krisi pushka. Mbas një lufte të rreptë që zgjati afro dy orë, ne mundëm ta çanim rrethimin. Por ata vazhdonin të na

ndiqnin dhe kishin prapë mundësi të na rrethonin. Unë, Taxhedini, që ishte një partizan i lindur e i rritur këtyre anëve dhe Anifja, një partizane që sapo i kishte mbushur të tetëmbëdhjetat, ishim caktuar në praparojë. Ne, më tepër se batalioni e ndjenim ndjekjen e armikut që s'na ndahej për asnjë çast. Dy herë u bëra gati të jepja urdhër për të zënë pritë dhe për të qëlluar pararojën e tyre që na qe afruar. Dhe të dyja herët Taxhedini m'u lut të prisnim dhe pak. Ai diç bluante në kokë. Dhe ja, në të dalë të pyllit, ai na tha: «Kam mendue që ne të marrim një rrugë tjetër nga ajo e batalionit. Vërtet që ne do të vemë në rrezik veten, por do t'i japim kështu rastin batalionit të mënjanohet nga ndjekja dhe të ketë kohë të marshojë i sigurt përpara».

Pastaj ai pa një copë herë nga unë, si për të marrë aprovimin tim dhe i hodhi një sy pyetës Anifes. Por ajo e vështroi Taxhedinin me kurajë dhe u kthye nga unë:

«Së bashku e morëm detyrën dhe së bashku do ta çojmë deri në fund».

Heshtëm përpara qëndrimit të saj.

«Mirë, — shtoi Taxhedini, — për nja dyqind-treqind metra do të dalim nga pylli dhe atëhere ata s'do ta kenë të lehtë me ne». — Dhe morëm rrugën nga filloi të na udhëheqë ai.

Mbrëmja vinte e bëhej përherë më e errët, si për të na fshehur më mirë nga sytë e etuar të armikut. Frynte një erë e fortë që lëkundte degët e vjetra të lisave shekullorë. Hera-herës dëgjonim që sipër kokave tona atë «krrakun» e thatë që nxjerr dega e thyer duke rënë poshtë. Kërkëllima

e saj bashkohej me fishkëllimën e plumbave që na kalonin pranë që pastaj era i merrte dhe i çonte larg. Herë pas here qëllonim dhe ne me automatikë për ta tërhequr armikun nga vetja dhe për ta larguar nga rruga që kishte marrë batalioni. Tani po dilnim nga pylli, që na kishte mbrojtur me drurët e tij trupmëdhenj dhe po kalonim në një gurishte. Era nisi të na rrihte përballë. Vendi ishte krejt i zhveshur. Taxhedini na dha zemër:

«Do t'i ngjitemi Kunorës nalt në majë. Atje do të jemi ma të mbrojtun».

Unë e Anifja ishim të një mendjeje me atë.

«Tashti do ta kuptojnë që janë gënjeje, kurse batalioni ka shkue larg, — shtoi Taxhedini. — Nga kjo ata do të tërbohen edhe ma shumë. Po ne, atje në majë, do t'i mbajmë gjer në fishekun e fundit».

«Gjer në fishekun e fundit» — thamë instinktivisht dhe unë me Anifen.

Dhe nisëm ngjitjen. Taxhedini printe. Poshtë u dëgjuan zëra të zemëruar dhe të shtëna të shumta në drejtimin tonë. Ne s'ju përgjegjëm.

Taxhedini e priste drejt udhën. Nga vështirësia e ngjitjes ndjenim se kishim të bënim me një të përpjetë të madhe. Ecnim fare pranë njëri-tjetrit. Plumbat na fishkëllenin herë pranë, e herë larg. Ata gjuanin më tym. Ata ishin përhapur rrëzë kodrës në formë gjysmë unaze dhe i ngjiteshin asaj duke e mbyllur përherë e më tepër rrethin. Ne vazhdonim të ecnim. Anifja për një çast e prishi drejtpëndrimin. Unë që isha pranë saj e mbajta që mos të rrëzohej. Me sa dukej një plumb qërr e kishte goditur në trup. Po ajo s'pipëtiu, as «oh» nuk tha.

«Mbahu, motër» — i thashë, me zërin që më dridhej nga frymëmarrja e shpeshtë. Atëhere dhe Taxhedini ndaloi.

«Ju ngjituni. Unë do t'u zë pritë mu këtu» — tha Anifja e vendosur.

«Jo, — tha Taxhedini, — atje, nalt në majë, të tre gjer në fishekun e fundit» — dhe e rrëmbeu Anifen në krahë. Unë nxora automatikun para gjoksit dhe u bëra gati të qëlloja në inat e sipër, por zëri burrëror i Taxhedinit ma preu hovin:

«Duro dhe pak, — më tha, — që ta marrim hakun mirë».

Dhe nisëm prapë ngjitjen e lodhshme. Errësira që po mbulonte vendin sikur mundohej të na mbronte nga armiqtë e egërsuar. Një copë herë e mbajta dhe unë Anifen në krahë. Nga kërciri i këmbës së djathtë që sipër gjurit, i rridhte gjak. Ecëm dhe ca ashtu derisa ngjitja na u vështirësua shumë. Tani ngjiteshim me këmbë e me duar. Me ndihmën tonë po zvarrisej dhe Anifja. Pas pak, përveç fishkëllimës së rreptë të erës nuk dëgjuam gjë tjetër. Gjermanët kishin heshtur së qëlluari. Kushedi ç'kishin menduar.

Po ne kishim mbërritur në majë.

— Ja këtu, — dhe Abazi i hodhi përsëri një vështrim rreth e qark vendit. — Dhe atëhere po kështu qe i gërmuar. Zëmë shpejt pozicionet, ja atje Taxhedini, pak më tej Anifja dhe kështu pritëm rreth dhjetë minuta, njëzet, tridhjetë...

Përveç fishkëllimës së erës, që lëpihej nëpër faqet e gurta të shkëmbinjve, s'dëgjohej gjë tjetër.

«S'ua mban të vijnë» — tha me inat Taxhedini.

Heshtje. Era vazhdonte të na ngacmonte veshët me fishkëllimën e saj.

«Mos duan të na zënë të gjallë!» — tha më pas Anifja.

«Të gjallë! — u hodh e tha Taxhedini, — jo, besa, të gjallë jo!» — dhe preku me gishtërinjtë e ftohtë fishekët që i kishte në karikatoren e mbërthyer për mes, hoqi një prej tyre, e mbajti ca në dorë, pastaj me lëvizje të ngathëta, zbërtheu kapakun e xhepit të xhaketës partizane, la fishekun brenda dhe po me ngathësi e mbërtheu prapë.

Bashkë me Anifen ndoqëm me vështrim të dhimbsur veprimet e tij. Thashë që Taxhedini s'kishte shumë që ishte bashkuar me batalionin tonë dhe s'kisha pasur kohë ta njihja mirë. «Ndoshta, — mendova, — Anifja e njeh më shumë nga unë». Po ajo kishte vënë dorën mbi buzë dhe mundohej të mbante ngashërimin. «Ç'i kujton vallë. — mendova, — shamia e bardhë e mëndafshhtë, e qëndisur me gonxhe trëndafili në ngjyrë të kuqe, që Taxhedini po mbante në duar? Mos vallë dhe ajo në këto çaste e kishte vënë ndjenjën e saj të çiltër para një prove si Taxhedini?! A dashuronte dhe ajo?!»

Për nder, që në ato çaste s'mendoja për vete. Vërtet që në shtëpi kisha lënë gruan me dy fëmijët, po për ato e kisha lodhur mendjen qysh se vendosa të dal malit. Pastaj e dija se, kur të çlirohej vendi, për ta do të kujdesoheshin shokët e mi, do të përpiqeshin komisarët. Taxhedini ishte i ri, trim dashuronte. Anifja e re, dhe ajo trimëreshë, ndoshta ende pa ja hapur zemrën dikujt. Këta duhej të jetonin ende, të bashkoheshin me shokët e



batalionit dhe të luftonin përkrah tyre, të luftonin dhe të fitonin, që Taxhedini ta jetonte ëndrrën e dashurisë së tij, ndërsa Anifja të dashuronte. Sa ma donte zemra që ajo për shortin e saj të kishte një djalë si Taxhedini!

«Ç'ke, Anife?» — i thashë ngadalë.

Ajo më ishte afruar pranë dhe matej të më thoshte diçka, që për të duhej të ishte me shumë rëndësi.

«Lëre Taxhedinin të shkojë. Të dy ne i mbajmë me zjarr këndeje, kurse ai le të zbresë nga ana tjetër. Mbase shpëton!» — më tha pas pak.

I hodha krahun në sup dhe e tërhoqa më pranë vetes.

«Dëgjo këtu, — i thashë me ton prindëror, — sa fishekë ke?»

«S'e di me saktësi, po ja ku i kam» — dhe më pa me habi duke më treguar karikatorët.

«Mirë. m'i jep gjysmat!»

M'i mbërtheu sytë me rreptësi, si të donte të thoshte: «Pse më kërkon atë që s'mund të ta jap!»

«Taxhedini duhet, po dhe ti, motër, do të shkosh me të. Ju jeni ende të rinj» — i fola miqësisht.

«Jo, — kumboi në çast zëri burrëror i Taxhedinit, — unë do të mbetem këtu. Ju keni bujtë në krahinën tonë. Më përket mue ta mbaj me zjarr kunorën. Dhe ta shifni po s'e mbajta. Kështu asht e thana. Ju shkoni këndeje. Ndoshta ata poshtë s'e kanë mbyllun ende rrethimin!»

Ishte i vendosur. I kishte dëgjuar fjalët që kishim shkëmbyer unë me Anifen dhe tani priste të aprovonim dëshirën e tij. Mbeta ngushtë. Si të

veproja! Mallëkova njëmijë herë veten që në zgjedhjen e praparojës nuk kisha marrë njerëz të moshuar. Doja të mendoja, të isha më i qetë, që vendimi që do merrja të mos më rëndonte ndërgjegjen. Ndaj hodha dhe një herë vështrimin rreth e qark. Era vazhdonte avazin e saj. Lart, retë të ngarkuara me reshje davariteshin ngadalë. Herë-herë, vende-vende yjet ndrisnin si llambushka të verdha që luhateshin lehtë.

«Hajdeni, — u fola me dashamirësi, — vëriini këtu gjithë fishekët!»

Në fillim ngurruan të dy, po kur më panë mua që zbërtheva i pari rripin e karikatorëve u çelën në fytyrë. I mbloodhëm të gjithë fishekët mbi një shami që Anifja shtroi pranë këmbëve tona.

«Kemi më?» — pyeta unë.

Taxhedini m'i nguli sytë rreptë.

«Nuk duhet të na shkojë asnji plumb kot. Nji plumb ma tepër do të thotë tashti një anmik ma pak. Më kupton, vëlla!»

Atëhere ai zgjati dorën, e toku fort me timen, si për të thënë: «fjalë burrash» dhe e mbajti ca ashtu të shtrënguar. Pastaj zbërtheu kopsën e xhakaventos, nxori fishekun dhe e la të pushonte pranë të tjerëve. Mbas tij Anifja uli sytë e drojtur, futi dorën në xhepin e pantallonave dhe e nxori prapë. Në dorë shtrëngonte diçka. Të dy me Taxhedinin i mbajtëm sytë te gishtat e saj të mbledhur.

«Megjithatë, — tha ajo si me ankim, — sikur të mbanim nga një s'do të qe gjë e madhe» — dhe e la fishekun e saj në shami.

Mbeta i shtangur dhe e mbajta gjatë vështri-

min te fytyra e saj e rrumbullakët. Të thoshte syri se ajo ishte ende çupurlinë për t'i bërë ballë një prove aq të madhe. Edhe Taxhedini në fillimi s'nxori zë. Po pastaj tundi dy-tri herë kokën i menduar dhe një buzëqeshje e çiltër ju përhap në buzë. Shtriu krahun, kapi shpejt dorën e Anifes, e toku fort me të tijën dhe pa nga unë, si për të thënë: «Hajde ta tokim të tre si burrat!» Nuk kisha ç'të prisja. I dhashë krahut përpara dhe i tokëm duart fort. Në fytyrat e lëvizjet plot gjallëri të Anifes e të Taxhedinit pasqyrohej një besim i madh, një këmbëngulje e madhe: do të ishim të vendosur deri në fund.

«Eh, sikur të kishim ma tepër plumba!» — tha i menduar Taxhedini.

«Po ju deshët të na i pakësonit dhe këto» — i thashë dhe i rashë krahëve.

«Jo, besa, i gjallë jo! — tha Taxhedini dhe ngriti sytë lart, si të desh të shihte diku, se si do t'ja dilte në minutat e fundit.

«Grykë më grykë» — thashë unë i vendosur.

«Po, besa, njashtu!» — tha shpejt Taxhedini.

Ndërkaq Anifja i kishte ndarë fishekët në tri pjesë. Morëm racionin dhe i radhitëm nëpër karikatorë. Unë me Taxhedinin zumë prapë pozicionet. Anifen e lamë prapa krahëve tanë të merrë me plagën që kishte marrë. I thashë të ndizte zjarr, me drutë që gjetëm aty, për të ngrohur ujin. Dhe ashtu bëri.

Unë me Taxhedinin ja kishim ngulur vështrimin errësirës dhe përgjonim. Në qiell hëna dhe yjet s'dukeshin gjëkund. Na dukej sikur mbi kokë na qëndronte një saç ngjyrë plumbi. Fillova të

shkoj nëpër mend gjëra të ndryshme dhe si për të lehtësuar barrën e mendimeve i fola Taxhedinit:

«E, si thua, a do të kenë shkuar përpara shokët e batalionit?»

«Duhet» — tha ngadalë ai, që me sa dukej i rrihte mendja atje ku më punonte dhe mua.

«Si thua, a i ndjekin vallë?» — e pyeta prapë me kureshtje.

«Po, duhet, o Abaz, — më tha, — duhet».

Ndejta pak pa folur duke menduar se sa e rëndësishme ishte detyra që kishte marrë përsipër të kryente batalioni ynë.

«Mundet të jenë nda dhe më dysh! — foli prapë Taxhedini. — Po si duket s'po ua mban të vijnë».

«Dreqi merret vesh me ta — shtova unë, — po mendoj se mos kanë kujtuar që kemi kaluar në anën tjetër të kurorës».

«Po pastaj?» — pyeti i shqetësuar Taxhedini.

«Them se mos kanë lënë larot të na presin këtu afër derisa t'u dorëzohemi».

«Të dorëzohemi! Po a dorëzohen burrat!» — foli Taxhedini si me vete.

«Shëët, po vijnë!» — thashë i emocionuar lehtë.

Shpejt zuri pozicion dhe Anifja dhe të tre filluam të mbajmë vesh mirë. Ashtu ishte. Drejt majës po afrohej tinëz një njeri.

«Ta lëmë të afrohet!» — urdhërova lehtë, dhe në çast të tre shkëmbyem vështrimet si për të thënë: «Po kjo?»

Njeriu që po vinte tinëz na ishte afruar shumë. Pritja e etshme na i kishte ngritur nervat, ndaj i thirra fort:

«Qëndro! T'i hodha trutë në erë!»

Atëhere njeriu që e kishim katër-pesë hapa larg ngriu në këmbë, si një statujë, me pushkën në dorë.

«Dëgjo këtu, — i fola i vendosur njeriut, që me sa dukej ishte malësor, — në qoftë se je i shitur me nder e burrëri, s'të lëmë më të afrohesh».

U prek në sedër, ndaj e uli pushkën poshtë në dorën e majtë dhe eci me hapa të matura përpara.

«Qëndro, — i thirra prapë, — ke të tjerë prapa?»

Por malësori me kokën e lëshuar përpara eci prapë pa dhënë përgjigje. Dukej i lodhur.

«Rexhë!» — i thirri Taxhedini kur malësori ndodhej para nesh.

Malësori u trondit kur dëgjoji emrin dhe pa nga Taxhedini me sy të hapur tej masës.

«Nëse ke ardhë për fjalë, ulu, pusho pak e pastaj folë. Po në ke ardhë për pushkë, mbrapa kthehu e u thuej shokëve të tu se ne do të qëndrojmë deri në fund».

Malësori pa rreth e qark dhe e mbajti vështrimin te Anifja, që sapo qe afruar. I erdhi shumë rëndë prej saj.

«Pse nuk shtitë?» — tha me burrëri.

«Se nuk është e lehtë me vra shqiptari shqiptarin!» — i thashë unë.

«Jo, ma mirë të kishit shti» — foli prapë malësori i turpëruar.

Ne s'i dhamë përgjegje.

«Po pse ke ardhë, o Rexhë?» — e pyeti pas pak me zë të dredhur Taxhedini.

«Me ju pa a jeni, a s'jeni!» — tha me zë të mekur malësori.

«E tash që na diktove, — i tha me ton të lartë Taxhedini, — shko e u thuaj atyre poshtë se po ju presim. Po prit njiherë — dhe ai zbërtheu shpejt xhakëtën e nxori nga xhepi i këmishës shaminë e bardhë të qëndisur me trëndafila të kuq. — Na, merre e çoja sat motre. S'e paskam ditë se gjaku i shtëpisë së saj qenka përlye me gjakun e tradhëtisë!»

Taxhedini heshti për pak, si për të ulur zemërimin që e kapi, po s'e përmbajti dot veten. Ndërkaq malësori ngriti kokën, e shtrëngoi fort pushkën dhe e tërhoqi lart.

«Shtij, — thirri me inat Taxhedini, — dhe mos u tut. Njashtu si s'tuteni tuj vra njerëz të pafajshëm, tuj plaçkitë, po, besa, tuj plaçkitë e tuj përdhunue cikat, motrat tona të mira».

Malësori çoi shpejt gishtin në këmbëzën e pushkës. Ndërkaq u dëgjua zhurma që bënë llozet e automatikëve tanë. Në një kohë me Anifen unë tërhoqa llozin dhe vura gishtin në këmbëzën e shkrepjes. Malësori nuk shtiu. I shtangur nga mendimet që e mundonin në ato çaste, ai i lëshoi krahet si të mpirë poshtë dhe e la mjekrën t'i binte mbi kraharor.

«Merre! — foli me zë të lartë Taxhedini, si të desh ta dëgjonin dhe larot poshtë, dhe e flaku shaminë drejt fytyrës së malësorit. — Dhe shko e jepja motrën ndonjenit prej trimave të Shahin Mancakut!»

Mua se si më erdhi që Taxhedini po e fyente aq rëndë malësinin, i cili kishte ngrirë në vend dhe dukej si një trung i thatë pa degë që pret ta rrëzojë furtuna. Tek e shihja ashtu duke bërë gjyqin

e vetëvetes më dhimbsej. Ndjaj ktheva kokën dhe pashë Taxhedinin. Ai ja kishte mbërthyer sytë malësorit dhe e vështronte rreptë. «A thua të jetë aq i pamëshirshëm!» — thashë me vete dhe u ktheva nga Anifja. Ajo ishte mbështetur në pozicionin e saj sikur përgjonte errësirën. Ndjeva që malësori lëvizi dhe u ktheva shpejt nga ana e tij. Ai la pushkën përtokë, zërtheu rripin e gjerë të fishekëve, e la dhe atë pranë pushkës, ra në gjunjë, mori shaminë, e fshiu me mëngën e xhaketës, e palosi katërsh dhe, si të vendoste një lule mbi varr, e la ngadalë mbi fishekët. Pastaj, pasi ndejti ca i mbështetur në gjunjë si të desh të falej, u ngrit i menduar dhe, pa vështruar fare nga ne, u kthye dhe me gjunjët që i dridheshin eci kokëulur përpara. Atëhere unë hodha shpejt vështrimin te Taxhedini dhe Anifja. Të dy ata i kishin drejtuar sytë nga malësori që po humbiste dalëngadalë në errësirë. Pas pak u dëgjua një diçka e rëndë, që u shemb përtokë dhe gurë që nisën të rrokulliseshin poshtë.

«Vrau veten» — tha Anifja me keqardhje.

«Ta kishim mbajtur» — thashë duke mos ditur si ta fshihja keqardhjen për malësorin, që me sa dukej s'i kishte hedhur të njëzetat.

«S'do të qëndronte, — tha Taxhedini, — këndeje vetëm një herë jepet besa». Dhe u ul, për të marrë shaminë që ngadalë dhe mendueshëm e futi prapë në gji.

«Po pushkën e la!» — thashë unë i habitur.

«Jo — tha me vendosmëri Taxhedini, — nuk e la, por na e dhuroi. Këndeje e duen shumë pushkën».

«Po për të qëlluar, nuk të qëlloi!» — thashë unë, që m'u kujtua çasti kur malësori vuri gishtin në këmbëz.

«E dija që s'do t'i banin gishtat me shti — tha Taxhedini. — Unë e njihja mirë Rexhën. Ka qenë gjithmonë njeri i ndershëm dhe njeriu i ndershëm s'të vret në befasi».

«Po ti i fole rëndë» — thashë unë.

«E kishte dhe hak, por desha ta ngacmoja që ta urrente Shahin Mancakun e të ikte prej tij. Dhe tamam krahu që do të zgjidhte ai për të zbritë kunorën do të ishte dhe krahu nga do çanim rrethimin. Dhe ai duhej ta bante këtë. Po me sa duket jemi rrethue nga të gjithë krahët».

Ndërkohë dhe Anifja që kthyer nga ne dhe një copë herë mbetëm të tre pa folur.

«Djalë i zgjuar» — mendova për Taxhedinin dhe m'u mbush kraharori me keqardhje kur kujtova se mund të mbetej përjetë këtu. Ndaj e vështrova nga këmbët gjer te koka, e vështrova mirë, si të desha ta fikësoja për të fundit herë në kujtesën time. Ishte i gjatë dhe nga shpatullat nuk vinte fort i mbushur. Flokët e zinj që i dilnin nga kapa i binin mbi ballin e ngushtë. Sytë i kishte të vegjël dhe të zinj si dhe flokët. Nga fytyra vinte i mprehtë dhe, ashtu i parruar dukej mjaft i dobët. Xhaketa bojë mjalti i rrinte mirë, ndërsa pantallonat e ngushta i qenë ngjitur pas gjymtyrëve të gjata. I shtyrë nga një ndienjë e pashpjegueshme pashë nga Anifja. Tek shihte Taxhedinin, ajo kishte kapur me të dyja duart rripin e automatikut dhe e mbante fort. Herë-herë harronte dhe e shihte atë gjatë.



«E ka gënjye Shahin Mancaku — foi si me vete Taxhedini. — E ka çue Rexhën me pa a jemi këtu!» — dhe shtangu gjatë në mendime, sa të dukej sikur ishte e para herë që ai mendonte seriozisht për rrethimin tonë.

Ndejtëm prapë pa folur me njëri-tjetrin, duke e pasur mendjen te malësori trim me emrin Rexhë dhe te rrethimi, kur ndjeva se Anifja po qante lehtë. «Ç'të ketë vallë?!» — mendova dhe u ktheva nga ajo. Një herë më shkoi mendja te malësori që sapo na e kujtoi Taxhedini. Por jo! Ishte një e qarë tjetër. Kraharori i kërcente fort dhe e mbërthyer në shqetësimin e saj ngrinte dorën dhe me gishtin që i dridhej mundahej të fshinte lotët. Po tek ngrinte sytë të shihte Taxhedinin, i harronte gishtat mbi mollëzën e faqes dhe humbiste në vështrimin e saj. Ç'të kishte? Atëhere ishim partizanë dhe, për më tepër të rrethuar. Po tani që kanë kaluar vite, rri e mendoj nganjëherë për Anifen e re me leshrat e verdha të thurura gërsheta. Dhe ajo vinte e gjatë nga trupi dhe kishte një fytyrë të mprehtë, po sytë i kishte më të thellë e më të bukur se të Taxhedinit. Sa i shkonte veshja partizane, e sidomos pantallonat e gjata që i kishte rregulluar vetë pas trupit!

«Të shtiem, të shtiem kot!» — u hodh e tha pas pak Taxhedini.

«Po pse?» — e pyeta i çuditur.

«Ju s'e njifni Shahin Mancakun! Ai do ta kuptojë se Rexha e ka tradhëtue, përderisa s'ju kthye. Hajt të shtiem në erë që të kujtojë se e vramë ne».

Unë me Anifen dëgjonim pa u kuptuar ende se ku donte ta nxirrte shoku ynë.

«Se ndryshe — tha si me vete Taxhedini, — Shahin Mancaku, njeriu më i poshtër i këtyne anëve, shkon e hakmerret me njerëzit e shtëpisë së Rexhës».

«Në qoftë ashtu, hajde! — thashë unë në formë urdhëri dhe shpejt kapa automatikun. — Vetëm nga dy fishekë!»

Dhe shtimë të tre në mënyrë të çrregullt. Pas kësaj Taxhedini e quante veten shumë borxhli ndaj nesh. Mua më vinte inat që ai pas qitjes që bëme rrinte i drojtur sikur të ishte fajtor. Ndoshta i vinte rëndë për plumbat që harxhuam. Anifja vazhdonte të rrinte e heshtur dhe e menduar.

Tek rrija duke përgjuar në pozicion, lloj-lloj mendimesh më lodhnin mendjen. Po mbi të gjitha më mundonte pritja e vazhdueshme. «Ndoshta vij në tani!» — thoja me vete. «Eh, sikur të vijnë!» «Mirë të vijnë, po sikur të kenë vendosur të na mbajnë të rrethuar gjatë?». «Hej, drej o punë, si s'na ra ndër mend më parë kjo gjë!» E përmblo-dha veten dhe solla ndër mend pasojat e një rrethimi të gjatë. «Po tani që u bindën se jemi këtu, ata mund të na mbajnë të rrethuar sa të duan» — hëngra inat me veten dhe shpejt mora një vendim! Hodha një herë sytë përreth, po asgjë. Errësirë dhe erë.

«Ej, Anife, Taxhedin! — thirra lehtë dhe u mblodhëm të tre kokë më kokë. — Sa më gjatë të presim, aq më keq do ta kemi. Mjaft pritëm. Tani na mbetet të çajmë rrethimin. Si thua — ju drejtova Taxhedinit — a zbresim dot nga ana tjetër e kurorës?»

Në fillim ai s'foli. I erdhi keq që po e linim

kurorën kështu. Po pastaj propozimi im e entuziazmoi.

«Mundet — tha ai — mund të ulemi teposhtë në drejtim të përroit, që e pret më dysh pyllin».

«Atëhere gati — thashë me ton të prerë dhe ju ktheva Anifes. — Si ndjehesh, motër?»

Ajo uli kokën. Dukej qartë se propozimi im i shpejtë e kishte shqetësuar.

«Në më doni — tha ajo me zërin që i dridhej — më lini të qëndroj këtu».

«Jo — thashë unë me ton autoritar — do të të mbajmë me radhë.»

«Po, besa, njashtu», — u hodh e tha Taxhedini dhe u bë gati ta mbante i pari Anifen në shpinë.

Ajo nuk tha gjë. I erdhi rëndë të na kundërshtonte. U bë dhe ajo gati dhe nisëm zbritjen.

Ecnim ngadalë dhe me kujdes që të mos rrokullisnim ndonjë gur poshtë. Duke zbritur më shkonte mendja tek takimi i befasishëm me pritën. Kur Taxhedini mbante Anifen, ecja unë para. Vazhdonim të zbrisnim duke i vendosur këmbët me kujdes, pranë gurëve dhe, megjithëse e kishim pritën të sigurtë përpara, mundoheshim të ishim të qetë. Ndoshta e bënim këtë për t'i dhënë kurajë njëri-tjetrit. Në ato çaste pasigurie dhe ankthi, kishim nevojë për guxim. Nisi të binte një shi i imtë. U ndalëm për të pushuar dhe Taxhedini u mundua të merrte me mend nëse kishim filluar zbritjen drejt përroit, po me sa dukej, nuk e lejonte shiu të dëgjonte gurgullimën e ujit. U nisëm përsëri me hap të matur duke i mbajtur armët përpara. Shiu nisi të binte më dendur. Dheu dhe gurët e lagur na detyronin të ecnim me shumë kujdes. Kur ja,

Taxhedini qëndroi papritur. Qëndrova dhe unë, e ula ngadalë Anifen pa bërë as më të voglën zhurmë. Megjithatë ai ma bëri me shënjë që të isha edhe më i matur gjatë lëvizjeve që bënim. Pastaj eci ca përpara e mbrapa dhe qëndroi të përgjonte më mirë. Unë me Anifen e vështronim Taxhedinin gjithë ankth. Pas pak ai na u afrua dhe tha me zë të dridhur:

«Mbërritëm në fund të kunorës. Dhe pak e futemi në pyll».

Instinktivisht, të dy me Anifen, vumë gishtat në këmbëzat e automatikëve dhe e mbajtëm frymën si të mendonim se vetëm disa metra larg qëndronin larot e Ballit. Po errësira s'të lejonte të shihje më tej se dy-tre metra. Zhurma e shiut u bë më e fortë dhe kjo na bindi se pyllin e kishim fare afër. Qëndruam pa folur dhe pa lëvizur për disa minuta dhe gjatë kësaj kohe zemra na rrihte fort. Nisëm përsëri ecjen. Po kësaj radhe të tre në këmbë. Anifja s'pranoi kurrsesi ta mbanim në shpinë. Ajo nisi të ecte me shumë mundim duke u mbajtur te krahu i Taxhedinit. Ecnim fare pranë njëri-tjetrit me tytat e armëve gjithmonë përpara. Unë isha i shqetësuar. Nuk më vinte keq që do të vritesha, sepse këtë e kishim menduar, por më shqetësonte mendimi se nuk do të kisha rast të qëlloja për t'u hakmarrë. E kuptonim përherë e më shumë që vendi ku shkelnim ishte i sheshtë dhe, përherë e më shumë dëgjonim zhurmën e shiut që përplasej nëpër drurët e zhveshur të pyllit e nëpër gjethet e rëna përtokë. Po ende veshët tanë s'kishin dëgjuar asnjë thirrje, asnjë krishtë! Më dukej sikur po kalonim në një vend të mi-

nuar ku nga çasti në çast do të shpërthente një gjënim i tmerrshëm...

Në pyll na dukej sikur pas çdo druri do të ishte fshehur ndonjë laro që matej të thërriste: «Ndal!» Dhe kështu, me këtë ankth kaluam bri pyllit derisa dolëm buzë përroit. U ndalëm për pak, morëm frymë thellë dhe kur pamë se kishim dalë pa u diktuar nga rrethimi u përqaftuam të tre njëherësh...

Po agonte mëngjezi i ftohtë, po ne s'e ndje-  
nim se na ngrohte shpresa e madhe për t'u bash-  
kuar me shokët e batalionit. Disa herë kthyem  
kokën prapa për të parë kurorën. Po shiu që binte,  
si një perde e dendur na pengonte pamjen. Sa  
dëshirë kisha ta shikoja edhe njëherë, po Taxhedini  
na futi përsëri në pyll që të kishim mundësi t'i  
largoheshim rrezikut që vazhdonte të na kanosej  
dhe njëkohësisht të bashkoheshim sa më shpejt  
me shokët.

Abazi heshti.

— Paskeni shpëtuar për mrekulli! — thashë  
unë i gëzuar.

— Ju paska ndihmuar fati! — tha Artani duke  
e parë Abazin me kureshtje.

— Ndoshta ashtu, po nuk duhen harruar dhe  
kushtet që na u krijuan, — tha ngadalë Abazi.

— Cilat kushte? — pyeti i habitur Artani.

— Me sa dukej kur dëgjuan të shtënat tona  
në majë të kurorës, larot e Ballit që prisnin posh-  
të e fjetën mendjen që ne do të qëndronim atje.  
Ndaj dhe prita u tregua e shkujdesur, — shtoi  
Abazi.

— Po, ashtu duhet të ketë ndodhur, — tha-

shë unë dhe u ngrita në këmbë. U ngrit dhe Artani dhe të dy me një gëzim në zemër, u bëmë gati të shkonim për dru.

— Do mundoheni, — tha Abazi — mund ta kalojmë natën dhe pa zjarr.

— Sonte kurora do të flakërojë nga zjarri partizan, — tha Artani me sy të qeshur.

— Atëhere shkojmë të tre, — tha i kënaqur Abazi, — që flaka të ndrisë e të na ngrohë sa më gjatë.

Dhe ashtu, pranë e pranë të tre, duke harruar lodhjen, morëm të tatëpjetën për të zbritur në pyll.

## NJË DITË PARA SE TË ÇLIROHEJ QYTETI. . .

Mesi i nëntorit. Bodrumi ku qemë strehuar ishte i madh, i errët dhe i ftohtë. Dritaret që s'kishin patur kurrë xhame, qenë zënë me jastëkë dhe rrobe të tjera. Përveç dritës, që ditën vinte nga hyrja, atë e ndriçonte dhe drita e qirinjve. Në luhatjen e flakës së tyre përkundej vështrimi ynë. Kishim dhe llamba me vajguri. Ato i përdorëm vetëm ditën dhe natën e parë, pastaj i zhdukëm. Vajguri në llambat do të na kujtonte neve, të vegjëlve, ujin që na mungonte. Kishim dy ditë e dy net që s'kishim vënë pikë uji në gojë. Buzët kishin filluar të na thaheshin dhe gjuha shpesh na mbeste midis tyre. Ne të vegjëlit rrinim të heshtur dhe numëronim të shtënat që vinin nga ndërtesa më e madhe e lagjes. Ajo ndërtesë na bëhej se ishte dhe më e madhja e qytetit dhe dukej sikur ishte ulur mu në prehër të Selitës së vogël. Në të kishin futur kokat «të mallëkuarit», kështu i quanin nënat tona gjermanët, dhe që andej ata gjuanin në shumë drejtime. Por ndërtesën tonë e qëllonin më shumë nga të tjerat, se u qëndronte përballë. Burrat që kishin mbetur lart në dhomat e kateve të sipërme, përgjonin nga dritaret

se mos afroheshin gjermanët dhe hera-herës qëllonin me pushkë në ndërtesën e madhe ku ishin armiqtë.

Unë isha ende i parritur dhe qëndroja përherë pranë nënës. Më dukej sikur ajo më mbronte nga çdo gjë e keqe, ndaj dhe e pyesja atë për shumë gjëra. Po më tepër doja të dija për ndërtesën, që më dukej më e madhja. E pyesja i drithëruar për të, se ajo ishte kthyer në një lubi që na kishte kallur tmerrin, na kishte mbyllur në bodrum, na kishte pushtuar çezmën dhe s'na linte të merrnim ujë, megjithëse e kishim afër. Dhe nëna më afronte dhe më thoshte:

— Do të vijnë partizanët, biro, dhe do ta zënë shtëpinë e madhe ku është futur armiku.

Të gjithë të rriturit lëviznin nëpër bodrum dhe të shqetësuar vrisnin mendjen për punën e ujit. Xha Rakipi, si më i shkathëti nga pleqtë e paktë që kishin mbetur në bodrum, u bë për ne të vegjëlit një njeri shumë i dashur. Dhe nëna shpesh e zinte emrin e tij në gojë. Tek na shikonte ne të vegjëlit me lot ndër sy e me buzë të thara, ai lëvizte poshtë e lart korridorit, shkëmbente vështrime të shqetësuarra me plakat e gratë e bodrumit, futej nëpër kthina, na afrohej neve dhe na përkëdhelte faqet me dhembzuri. Dhe saherë që xha Rakipi më vinte pranë, më dukej sikur pas pak do të gjendej uji. Dhe vërtet, ai dha mendimin e i pari nisi punën për hapjen e një pusi në fund të korridorit. Ai u lodh shumë duke punuar me kazmë. Dhe nëna ju lut t'ja merrte, që ta ndihmonte dhe ajo në hapjen e pusit. Por xha Rakipi s'e lëshoi kazmën nga dora. Pas ca orë pune të lodhshme ai fshiu



djersën e ballit me pëllëmbën e dorës, hodhi vështrimin rreth e rrotull, pa nga ne fëmijët që i qemë afruar pranë dhe, pasi la me pikëllim bishtin e thyer të kazmës që i kishte mbetur te gurët e betonit, nisi të na përkëdhelte. Kur nëna u afrua të më merrte, ai i foli asaj me ngadalë:

— Mezi shpohet. E kanë betonuar trashë, — dhe me zë të paktë, që unë s'munda ta dëgjoja, seç i tha nënës.

Kur u ulëm në qoshen tonë, nëna më premtoi se, kur të ngrysej, do të pinim ujë. Nga mënyra se si foli m'u duk se dhe ajo s'u besonte fjalëve që tha. E ndjeja se ajo kishte rënë në mendime, se parandjente diçka, se po priste të ndodhte diçka. Pas pak te sheshi i vogël në hyrje të shkallëve u dëgjuan fjalë me zë të lartë sikur grindeshin njerëz. Unë brofa te dera. Po nëna më kapi për krahu dhe s'më la të afrohesha. Po dhe ashtu unë arrita të shikoja ata që qenë mbledhur te kryet e shkallëve dhe si me inat shkëmbenin fjalë me njëri-tjetrin. Me sa kuptova xha Rakipi donte të bënte prapë diçka për ne të vegjëlit, por tre-katër pleq të tjerë e pengonin. Dhe teto Lefta u qe afruar dhe jepte e merrte me ta.

— Do të vete se s'bën! — thoshte i vendosur xha Rakipi dhe gjymin s'e lëshonte nga dora.

— Do të të vrasin, o lumëmadh, — ja ktheu xha Myslymi dhe mundohej t'i rrëmbente gjymin nga dora.

— Lëre. ore, të shkojë, — ja priti teto Lefta, — se dikush duhet të shkojë. Nuk e sheh që u thanë fëmija?

— Mirë, o Leftë, — i foli me zë të shtruar

xha Myrtua, — po dëgjo si qëllojnë. Qëllojnë e s'pushojnë një minutë. S'i themi kot të mos shkojë.

— Po dhe kështu s'kalohet, — u hodh e tha xha Rakipi. — Çilimijtë s'durojnë më. Apo doni ta dëgjojë dhe gjermani të qarën e tyre?

— Po të presim dhe ca, o Rakip, — u hodh e tha një plak tjetër që s'munda ta dalloj mirë se cili qe, — të presim sa të erret mirë dhe pastaj s'të lëmë të shkosh vetëm.

— Mirë thua ti, po do t'ju hedhin prozhektorin, — tha prapë me zë të lartë teto Lefta.

U bë një heshtje e shkurtër. Dëgjohej tek-tuk ndonjë e qëlluar lart nga dritaret e sipërme dhe pastaj zëri i xha Myrtos:

— Ja, e hodhën, sikur na dëgjuan që po pregatitemi për të shkuar te çesma.

-- Të poshtërit! — shau nëpër dhëmbë nëna.

— I kanë prurë nga anë e anës këta sy djaj për të na e bërë natën ditë. U djegshin vetë me ato drita të forta! Të mallëkuarit! — shau një grua në inat e sipër, në dhomën përtej nesh.

— Po hajde, se s'e kanë të gjatë, — ja priti teto Lefta. — Ku janë gjermanët që ishin! Na janë mbyllur brenda si minjtë.

Nga të katër anët e bodrumit dëgjoheshin zëra e pëshpëritje. S'merrej vesh mirë a qenë mallëkime, apo ankesa që dikush të shkonte patjetër për ujë. Xha Rakua me shokët e tij e teto Leftën mbetën si të habitur. U dëgjua një zhurmë që vinte nga shkallët e kateve të sipërme sikur nëpër to po shembej një njeri. Të gjithë mbajtëm vesh dhe ja ngulëm sytë kreut të shkallëve. S'vonoi dhe ai që ishte rrokullisur nëpër shkallë u hodh po me kërcim dhe, te sheshi i vogël i korridorit u ndodh ballë për ballë me xha

Rakipin që i doli përpara. Ishte Muharremi, babai i Velos, shokut tim që rrinte në një dhomë para nesh. Me fytyrë të shqetësuar dhe pa e marrë veten mirë foli si me vete:

— S'të lënë qentë. Qëllojnë ku të mundin. Dhe nëpër shkallë qëllojnë. — Pastaj u mundua të qëndrohej dhe, pasi hodhi sytë përreth, pyeti shpejt:

— Ç'ka ndodhur këtej?

— S'ka ndodhur gjë, — tha i menduar xha Rakipi, — po përgatiteshim të shkonim për ujë.

— Ku? — pyeti prapë shpejt babai i Velos.

— Te çesma përjashta, — u përgjegj xha Rakipi.

— Jo, — tha prerë babai i Velos, — te çesma jo! Nuk dëgjoni si qëllojnë e si hedhin prozhektorin? Janë tërbuar qentë. U erdhi fundi. Ju mos u druani, se s'i lëmë të afrohen këtej. — Pastaj heshti për pak, si të mendohej më mirë dhe shtoi: — Për ujë do të shkoni te pusi i Frashërve. Dhe andej qëllojnë, po jo kaq shumë sa te çesma — dhe ju drejtua xha Rakipit. — Tani s'bën, o Rako, duhet të erret ca. Po më mirë prisni, se unë do të zbres prapë më vonë.

— Jo, — e kundërshtoi xha Rakipi i prekur në sedër — për ujë do të vemë ne. Ju qëndroni lart, se atje është detyra juaj.

— Atëhere mirë, — tha babai i Velos, — kur ne të shpëshojmë të shtënat, ju nisuni, — dhe, pasi bëri dy-tre hapa para, thirri: — Durim, motra, durim, se pushka partizane po dëgjohet këtej rrotull. Me sa duket i erdhi radha edhe lagjes sonë të çlirohet. — Pastaj u kthye, priti pak sa drita e prozhektorit u zhduk nga shkallët dhe u turr drejt tyre duke kërcyer nga katër e nga pesë përnjëherësh.

Prapë heshtje e shkurtër. Të gjitha nënat e

gjyshet që kishin dalë në korridor mbetën një çast pa lëvizur me grushtat shtrënguar. Pastaj dalëngadalë u futën të menduara nëpër dhoma, duke shkëmbyer ndonjë fjalë me njëra-tjetrën. Vetëm xha Rakipi me pleqtë e tjerë e me teto Leftën mbetën prapë te sheshi i vogël i korridorit duke pritur që të errej.

Ndërkohë i isha futur nënës në kraharor aq sa ja dëgjoja qartë të rrahurat e zemrës, dhe përfytyroja se si edhe tek ne do të vinin partizanët. Vrisja mendjen se nga ç'anë mund të vinin, sa mund të ishin dhe, nëse komandanti i tyre do të zbriste në bodrumin tonë?! Tek rrija ashtu s'më kujtohej puna e ujit. Dhe ja ku ndjeva dorën e nënës të më prekte e merakosur leshrat e mia të verdha e kaçurrela. «Diçka duhet të ketë nëna, — mendova shpejt, — ndryshe ajo do të vazhdonte të më përkëdhelte!» Ndaj ngrita kokën dhe pushë sytë e saj të mbërthyer të hyrja e shkallëve, sikur priste që andej të hynte dikush nga çasti në çast.

Me të dyja duart e mia kapa lehtë dorën tjetër të nënës, që kishte mbetur e varur mbi supin tim. Atëhere ajo nisi të më lëmonte lehtas flokët. Të rrahurat e zemrës së saj vazhdonin të godisnin me forcë në gjoksin e dobësuar... Ajo prapë e harroi dorën mbi flokët e mi të verdhë.

— Ç'ke nënë? — i thashë dhe ju afrova më pranë. Po nëna s'më dha përgjigje. Ajo më mbërtheu me të dyja duart nga krahët dhe më shtrëngoi fort në kraharor.

— Po më thuaj, moj nënë, ç'ke? — ngula këmbë unë.

Ajo tani filloi të m'i lëmonte flokët me të dyja duart.

— Dikush po vjen, bir, nuk e ndjen?... Ja, dëgjoje...

Atëhere edhe unë u mundova të mbaja vesh mirë. Vërtet që pranë dritares sonë, që binte nga ana e pasme e ndërtesës ecnin njerëz. Ecnin dhe përpiqeshin të afroheshin te shkallët.

— Ç'mund të jenë, moj nënë?

Ajo më puthi lehtë flokët dhe më foli me gjysmë zëri:

— Prit njëherë, bir!

Nëna kishte të drejtë. I tërë bodrumi kishte heshtur dhe të dukej se të gjithë i kishin mbërthyer sytë te hyrja e errët. Ja, nëpër shkallë u dëgjuan hapa... Bodrumi u errësua, qirinjtë u fikën. Hapat ndiheshin sipër kokave tona. Lart, në katin e parë kishin ardhur njerëz. Tani ata po zbrisnin shkallët e bodrumit dhe ndaluan te sheshi i vogël poshtë shkallëve. Heshtja u bë më e thellë, pastaj ai që sapo zbriti i pari thirri:

— Vdekje fashizmit, shokë!

— Liri popullit! — thirrëm të gjithë të ngritur instinktivisht në këmbë me dorën grusht te balli.

Pastaj u ndezën qirinjtë e nisën thirrjet tona të gëzuara:

— Partizanët! Erdhën partizanët!

Nëna më mori në krahë dhe më puthi me ato buzët e saj të thara. Ajo po qante. Unë i hodha krahet nënës dhe e putha. Po s'më qahej. Unë e dija që ata do të vinin. Vetë nëna ma kishte thënë këtë. Dhe ja ku erdhën. Partizanët kishin kohë që kishin hyrë në zemrën time. Po tani doja t'i shihja me sy. Ju shkëputa nënës dhe renda në korridor drejt partizanëve. Po për habinë time ishte një partizan i

vetëm. «Po të tjerët, — mendova — pse s'po vinë?» Dhe u ktheva nga nëna si për të marrë përgjigje. Ajo kishte mbetur te dera si e habitur, pastaj u kujtua që unë kisha qëndruar në mes të korridorit e më tha me zërin e saj të mekur:

— Shko, bir, shko!

Unë shkova u bashkova me fëmijët e tjerë që kishin bërë një rreth të vogël dhe e kishin futur partizanin në mes. Ai nisi të na përkëdhelte të gjithë me radhë dhe secili prej nesh donte që partizani ta përkëdhelte sa më gjatë. Pleqtë po vinin që ta takonin. Ne i pengonim ata duke dashur të qëndronim sa më gjatë pranë tij. Mua më shkrepën në kokë në ato çaste dy dëshira: Të më merrte partizani ndër duar e të më puthte para gjithë shokëve dhe të pija pak ujë. Po tani ai po përshëndetej me të mëdhenjtë, dhe njëkohësisht unë vura re se në rrip ai nuk e kishte varur pagurin. Ai na buzëqeshte lehtë dhe nganjëherë i mbeteshin sytë te buzët tona të thara e të prera nga vijëza të kuqe.

Pastaj xha Rakipi na këshilloi ta linim pak të lirë partizanin që të pushonte. Unë u ktheva nga nëna. Ajo më uli përsëri në prehër dhe nisi të më lëmonte flokët. S'më ndahej nga mendja partizani, trupi i tij i madh, mustaqet e tij të rritura shumë, rrobet e tij ngjyrë vaji, rripi i gjerë që mbante në brez, ku kishte varur një revole me grykë të gjatë, gjerdani i tij me fishekë që i përshkonte kraharorin tërthorazi nga lart poshtë, qillotat e tij, dollakët dhe këpucët me qafa të pluhurosura. E mbi të gjitha ylli, ylli i kuq partizan, që unë kisha aq dëshirë ta mbaja ndër duar e ta vija në jakën e xhakëtës së vjetër.

...Heshtja ra sërish. Dëgjoheshin vetëm hapat e

partizanit që lëvizte nga një dritare tek tjetra për të vëzhguar përjashta, dhe hapat e atyre që kishin mbetur të vëzhgonin lart. Të gjithë, kur ai u kalonte pranë, e vështronin me kërshtëri.

Unë mendoja: «Pse erdhi ai këtu? Sa larg i ka shokët e tij partizanë? Përse tani vëzhgon herë pas here përjashta?» Këtyre pyetjeve unë s'munda dot t'u jepja përgjigje. Ndaj ngrita sytë e u bëra gati për të pyetur nënën. Po ajo si përherë edhe tani më kuptoi:

— Është zbulues, bir, — më tha pa ma ndarë dorën nga flokët. Ka ardhur me shokët, po ata kanë mbetur lart.

«Zbulues» — belbëzova unë. Nuk e merrja me mend se ç'donte të zbulonte. Ndërkohë nga fundi i dhomës u ndje një zë i thekshëm:

— Korba unë! Më iku foshnja për një pikë ujë! Ma thanë të mallëkuarit, ma thanë!

Ishte teto Ksanthipi që banonte pranë nesh. Ajo me flokë të shpupuritur kishte vënë gishtat e dorës në gojë që të mos i dëgjohej zëri dhe, duke mbajtur fort gjymin në dorën tjetër, po nisej për të dalë përjashta. Ndërkaq partizani i doli përpara shpejt dhe e ndaloi.

— Motër, mbahu! — dhe e mori për krahu për ta çuar te fëmija.

— Pak, fare pak, sa për t'i njomur buzët se m'u tha vogëlushi i nënës, — u mundua ta kundërshtonte ajo. Por ai, me ngadalë e futi atë në dhomën ku qe shtrirë fëmija e vogël që vazhdonte të qante me të madhe dhe, pasi e mori ndër duar, u mundua ta pushonte. Pastaj rrëmbeu gjymin e bëri të dilte përjashta. Ndërkaq njerëzit dolën përsëri në korridor, kurse xha Rakipi i doli përpara dhe e ndaloi:

— Jo, — i tha i vendosur dhe me fytyrë të vrenjtur pa nga pleqtë e tjerë. — Për ujë do të vemë ne. Sapo do të niseshim, — tha dhe i tregoi gjymin që e kishte lënë te qoshja e shkallëve. — Ti qëndro e kryej detyrën tënde, — dhe zgjati dorën t'i rrëmbente gjymin partizanit.

Por ai s'e lëshoi. Atëhere para partizanit dolën xha Myrtua me dy pleq të tjerë, si për t'i thënë atij: «jemi dhe ne të tjerët këtu!»

Partizani buzëqeshi lehtë dhe u ra krahëve të xha Rakipit:

— Keq, — tha lehtë, — keq që paskeni mbetur pa armë.

— Ua kemi dhënë djemve lart, — tha xha Rakipi, — dëgjoni si qëllojnë. Ne s'na mbajtën. «Shkoni poshtë me fëmijët — na thanë, — se s'bën t'i lëmë vetëm.» — Dhe ne zbritëm poshtë te fëmijët — shtoi xha Rakipi me pikëllim.

— Mirë fort, — tha partizani, — domethënë dhe këtu luftohet. Po prisni pak, — dhe la gjymin, kërceu shkallët e para dhe shkoi te shokët që kishin mbetur lart, për t'u marrë lejë që të shkonte për ujë.

Sapo zbriti partizani rrëmbeu gjymin dhe i tha xha Rakipit me një frymë:

— E di çesmën?

— Ja tek është, — dhe xha Rakipi bëri me kokë nga ana e çesmës, — po s'të lënë të poshtërit. Të qëllojnë më parë me prozhektor, pastaj me mitraloz.

Partizani mblodhi buzët. S'i pëlqyen fjalët që tha xha Rakipi.

— Po për ujë do të vemë te pusi i Frashërve. Është ca më larg. po do t'i biem nga pas ndërtesës dhe për një copë rrugë s'na diktojnë dot.

— Atëhere shkojmë, — tha partizani.



— Dhe pak, — tha xha Rakipi dhe bëri shenjë me dorë nga ata që luftonin lart nëpër dritaret.

Partizani në fillim s'e kuptoi. Po kur u shpeshuan të shtënat nga dritaret e ndërtesës, xha Rakipi tha:

— Tani po.

I pari që kërceu shkallët dhe doli jashtë qe partizani. Pas tij me gjymin në dorë kërceu shkallët dhe xha Rakipi. Në bodrum ra përsëri heshtja. Po kjo zgjati shumë pak, se bodrumi ynë u mbush me zëra si kurrë ndonjëherë. E para që e nisi këngën qe teto Lefta, pastaj ja morën të gjitha së bashku. Këndonte dhe nëna. Dhe sa mirë që ja thoshte! «E nga i di kjo këngët partizane!» — mendoja dhe e shihja nënën me gëzim. Ju afrova fare pranë dhe nisa të këndoja dhe unë. Sa mirë bëmë që ja morëm këngës. Mua më dukej se gjermanët e dëgjonin këngën tonë dhe sa s'pëlcisnin nga inati. Dhe s'këndonim vetëm ne të bodrumit. Këndonin dhe baballarët që luftonin nga dritaret e sipërme, këndonin dhe partizanët që kishin ardhur në katin e parë, dhe mua më bëhej sikur këndonte e gjithë lagjja jonë. Ndaj i kapa dorën nënës dhe e pyeta:

— Po në shtëpitë e tjera këndojnë?

— Të gjithë janë të gëzuar, — tha ajo, — së shpejti vijnë partizanët, dhe atëhere... — Po nëna ja mori këngës prapë.

— Po atëhere, nënë?

— Do çlirohet lagjja jonë dhe i gjithë qyteti, e kështu katilat do të shporren një herë e mirë.

— Po ujë do të pimë? — thashë unë i mera-kosur.

— Do të pimë, bir. Tani do të jenë duke u kthyer.

— E hodhën prozhektorin dhe nga pusi i Fra-shërve — thirri një grua në dhomën përballë nesh, që kishte hapur një vrimë te dritarja dhe përgjonte përjashta.

— I diktuan — tha nëna dhe e merakosur më shtrëngoi më pranë vetes.

Kënga dalëngadalë pushoi fare dhe të gjithë të mëdhenjtë mbanin vesh përjashta. Të shtënat dëgjoheshin më të rrepta. Gjermanët nisën të qëllonin dhe me mitraloz. Minutat ecnin dhe ecnin. Po ne qëndronim më këmbë në korridorin e ngushtë të bodrumit duke i mbajtur sytë të mbërthyer te shkallët. Dhe ata lart e mbajtën këngën dhe nisën të qëllonin më shumë...

— Nënë, — pyeta unë ngadalë, — po kur do të vijnë?

Ajo s'më dha përgjigje. I mbante sytë e saj të plakur para kohe andej nga i mbanim të gjithë, si për të më thënë: «Ja, nuk i sheh, bir, që po vijnë!»

Dhe nëna kishte të drejtë. Nga shkallët erdhi një zhurmë e lehtë që të bënte të mendoje se dikush po zvarrisej. Ne të gjithë bëmë përpara dhe u afruam te sheshi i vogël i korridorit. Dhe ja, te praku i shkallëve partizani drejtoi trupin dhe, duke shtrënguar nofullat, për të mposhtur dhembjen, zbriti shkallët dhe i la të dy gjymat para syve tanë. Pastaj u kthye përsëri andej nga erdhi dhe prapë kërceu shkallët.

— Qenka plagosur! — tha teto Lefta me gjysmë zëri.

— Dhe erdhi sikur s'kishte gjë në trup — tha xha Myrtua.

— Dhe doli prapë... — shtoi teto Lefta e habitur. Gjymat mbetën ashtu siç i kishte lënë ai. Asnjë

nga fëmijët nuk po u afrohej. Vetëm xha Myrtua eci rëndë, rrëmbeu një gjym dhe eci ngadalë në drejtim të qoshes ku rrinte teto Ksanthipi... Mitralozi gjerman vazhdonte të gjëmonte si i marrë. Te praku u dëgjua përsëri një zhurmë e lehtë, përsëri hapat e partizanit nëpër shkallë dhe përsëri na u shfaq figura e partizanit, me xha Rakipin të lëshuar mbi shpatullat e tij... Dhe përsëri e thirrura e dhemshur e teto Leftës:

— Oh, e paskan qëlluar dhe Rakon tonë!

— Ule, ule këtu. Gjallë është? — pyeti shpejt xha Myrtua.

— Gjallë, — tha partizani me dhimbje.

Vështruan të gjithë rreth e qark për të ndeshur partizanin dhe për ta falënderuar atë me gjithë zemër. Por më kot. Ai s'qe.

— Iku! — tha njëri nga pleqtë.

— Shumë shpejt, — tha teto Krisanthi që me fëmijën në krah ishte afruar për ta falënderuar partizanin.

— Me sa duket ka shkuar lart te shokët e tij — tha prapë teto Lefta.

— Nuk qëndroi as për t'i lidhur plagën, — tha i merakosur xha Myrtua, tek po i zbërthente këmishën e gjakosur xha Rakipit. — Po do të kthehet, keni për të parë që do të kthehet.

— Ashtu më tha kur shkonim barkaz, që në të gdhirë do të vijë me të gjithë shokët e batalionit, — tha xha Rakipi si nëpër ëndërr.

— Do të kthehet, — tha dhe nëna dhe u ul të merrte një tas të vogël për ta mbushur me ujë.

«Zbulues — pëshpërita unë, — eja prapë se po të presim» — dhe afrova me etje tasin me ujë pranë buzëve.

## KUR «BUZËQESHTE» BEU

Mbrëmjen e përvjetorit të parë të çlirimit Reiz Huta, që banonte në periferi të qytetit, kishte shtruar rakinë në sofrën e bukës. Rrallë e tek e bënte këtë, jo se nuk e donte të shkretën, por se vetë ai rrallë ndjehej i gëzuar.

— E, — i foli gruas që po qëndronte përballë, — sonte duhej e shkreta!

Ajo s'ua vuri veshin fort fjalëve të tij dhe e çoi vështrimin te fëmijët, që ishin mbuluar me një rrobe të leshtë në vend të jorganit.

— Si qengjat flenë, — tha ngadalë Reizi, që tani e kishte kthyer dhe ai kokën andej. — T'i kishim dhënë një gotë të madhit, s'do të kishim bërë keq.

— Lëre, se mësohet, — tha gruaja. — Pastaj ishte i dërmuar. S'ja pe syrin e djathtë që e kishte të buhavitur. Janë zënë prapë me fëmijët e Eqrem beut.

— Fëmijë! Lufta ka një vit që ka mbaruar dhe këta ende luftojnë.

— Thonë se bëhet luftë në veri me ata që janë fshehur maleve. Mirë, lojën partizanë-ballistë e duan

dhe e luajnë gjithë fëmijët, po këta të lagjes sonë zihen me të vërtetë. E pse s'i shkulin njëheresh këta të Ballit, po i lanë disa, sa për të na ngatërruar këmbët dhe të na zihen fëmijët?

— Dalëngadalë, grua, dalëngadalë. Nuk qethen të gjitha dhentë njëheresh.

— Po Eqrem beun, a do ta shkulin, si ta thotë mendja!

— Për të luajtur gishtin, s'e luajti as me Ballin as me partizanët, po ama, anën e armiqve mbajti. Ti e ke parë vetë, me italianët grurë, me gjermanët po grurë.

— Po tokat, s'ja lojtën që s'ja lojtën! U tha në fillim se do t'ua merrnin të gjithëve e do t'ua jepnin të varfërve. Ja dhe tani nëpër mbledhje të njëjtën gjë thonë. Vetëm se tani i thonë «reformë agrare».

Reizi mbeti i pikëlluar. Gruaja, pa të keq, e kishte qëlluar me fjalët që tha, aty ku i dhimbte me kohë. Eh, toka e shkretë! Kish vite që ëndërronte për një copë tokë të tijën. Ndaj kishte lënë fshatin dhe kish ardhur në qytet, me shpresë se mund të punonte si argat e pastaj me djersën e tij të mund t'i shkëpuste beut ndonjë copë arë që ta kishte për vete. I qante zemra për një copë tokë.

— T'i kishim dhënë një gotë të madhit, — e drodhi fjalën Reizi. — Tani u bë burrë. Fola me Idrizin që ka nisur punë në kazemat. Pas votimeve do ta marrë me vete. Të merret me çfarëdolloj pune andej, se këtej nga tokat s'ka çfarë të presë më.

Gruaja ktheu kokën përsëri nga fëmijët dhe u çua në këmbë, ju afrua e i mbuloi më mirë me rroben e leshtë. Pastaj u ul përsëri në vendin e saj.

Reizi e mbushi gotën me raki dhe jepte e merrte me vete. Pastaj e vuri gotën në buzë, piu vetëm një gllënkë dhe e uli gotën në sofër si i penduar.

— Të shkretën, po ku e gjetën shtëpinë e Isa Selamit për të votuar! — tha si me të sharë, duke e pasur inatin te tokat që ende i mbante Eqrem beu.

— E ç'ke me të, o derëzi, ai plumbin desh, plumb mori.

— Po ja, bëj sa bëj dhe atje më vete e uruara. Këta të frontit njerëz të mirë, të pushkës që ç'ke me të, për popullin që ç'ke me të, babaxhanë njerëz. Po prapë..!

— Ke parë ti, që dhe mua atje më rri mendja, — tha gruaja e nxituar. Ja dhe tri ditë mbetën. Nuk e di, nuk e di, po ama llotari e madhe kjo që do bëhet. S'është bërë ndonjëherë kështu! S'janë mbushur kështu muret me parulla, njerëzit s'kanë qenë ndonjëherë kaq të gëzuar e të shqetësuar njëkohësisht! Sa për shtëpinë e Isait aq më bën. Fundja s'ke ku ja gjen shoqen!

Reizi shtrëngoi gotën e vogël të rakisë me inat. I dukej se, meqë do të bëheshin votimet te shtëpia e tradhëtarit, dhe zgjedhjet s'do të venin mbarë.

— T'u kishin ndarë njëherë tokat të varfërve, pa le ç'do të vente pastaj!

Gruaja s'i dha përgjegje, po zgjati dorën dhe mori pak djathë.

Në mëngjez, Reizi s'u ngrit herët si përditë. Gjumi e kishte zënë andej nga mesnata, e ndoshta dhe më vonë.

Kur u nis të shkonte për në arë, rrugës takoi

Eqrem beun. U përshëndet me të si pa qejf, ndërsa beu i foli me përzemërsi:

— Dil njëherë sot nga pazari, se mos gjen njeri dhe na e shet kashtën e misrit. Do të zënë shirat e pastaj hajde ta shesësh aq sa ja vlen.

«Qerrata i madh është, — mendoj Reizi, — s'ka pak që mbushi xhepat me misrin që shiti fshehurazi dhe tani do të heqë qafe dhe kashtën».

— Dhe shite sa ta shesësh, — i foli prapë Eqrem beu. Paratë mbaji për vete. I ke hak. Ke punuar vet i tretë në arë, sivjet.

Kjo s'i kishte shkuar në mendje Reizit. Po megjithatë i erdhi mirë kur e dëgjoi t'i thoshte për paratë. E falënderoi Eqrem beun dhe u mat të largohej.

— Na, Reiz! I thuaj gruas t'u blejë nga një palë rrobe fëmijëve. Po mos harroni të visheni dhe për vete. Pasnesër është ditë e shënuar!

— Ashtu është, zoti Eqrem, — tha shpejt Reizi dhe mori rrugën e pazarit. Nxitonte dhe s'mendonte gjë tjetër veçse t'i gjente myshteri kashtës. Pastaj do të kthehej në shtëpi e do t'i thoshte gruas: «Merri këto, grua, dhe dil e m'i vish njëherë këto fëmijë, pastaj dalim e zgjedhim ndonjë gjë dhe për vete».

U takua me shumë vetë Reiz Huta, në pazar, po ende s'po e gjente njeriun që kërkonte. Dhe u habit kur dëgjoi nga pas zërin e Eqrem beut, që e thërriste nga dritarja e kafenesë në mes të pazarit. «T'i jetë ndërruar mendja, — mendoj me pikëllim, — po ai e tha me gojën e vet, që në arat e tij sivjet ka punuar dhe gruaja me djalin e madh», — dhe, pasi u kthye me hapa të rënduar, hyri në kafene.

Po Eqrem beu ishte në qejf. Kur Reizi u afrua, ai i bëri shenjë që të ulej pranë tij dhe shpejt porositi diçka dhe për të.

— Mos, zoti Eqrem, se akoma s'e kam shitur kashtën.

— Akoma me kashtën, o Reiz! Të pimë njëherë, pastaj shohim e bëjmë.

Reizi nderi si pa qejf pranë tij. Mendonte se pikërisht tani që po rrinte në kafene do të kishte rastisur në njeriun që donte.

— Prapë me kashtën ti! — tha si me të qeshur Eqrem beu. — Po mblidhe, mblidhe njëherë kashtën e kokës! Te paratë e ke syun. Të jep Eqremi, — dhe futi dorën në xhep e nxori kuletën. Ja, o Reiz, me tënden, sa do t'i marrësh kashtës?

— Po si të them, Eqrem bej! Dhjetë napolona, kaq e bëra hesap kur vija rrugës, se s'janë si më parë.

— I ke rënë në të. Ja, po t'i jap unë të dhjetë napolonat. Shite kashtën njëherë...

— Jo, zoti Eqrem, kështu s't'i marr! — e kundërshtoi shpejt Reizi.

— Po merri njëherë dhe vish kalamanjtë e veten, pa këtu na ke edhe kashtën edhe mua.

Reizi i mori paratë dhe i futi në xhep me drojtje. S'donte t'ja merre, po qejfi ja kishte të shkorte në votime me rrobe të reja. Pastaj kashtën në mos sot nesër do ta shiste dhe ja ku do t'ja jepte prapë paratë.

— Hajde, gëzuar, Reiz! — i tha gjithë qejf Eqrem beu.

— Gëzuar dhe zotrote! — ja ktheu Reizi.



— Të pimë një herë sot, se për pasnesër kemi kohë ta tundim.

— Po, po, ashtu, — ja ktheu prapë Reizi.

Heshtën që të dy një copë herë. Eqrem beu e hapi prapë muhabetin.

— Habitem me ty, o Reiz! Si s'të vjen të pël-casësh me llafet që po fliten poshtë e lart!

Reizi ngriti sytë dhe u bë kureshtar, po s'pyeti.

— S'po merret vesh se ç'duan të bëjnë këta të frontit me tokat. Një zot e di se si do të shkojë puna.

Reizi i hapi edhe më sytë nga kureshtja.

— More, po janë shkukur të gjithë dhe thonë se do marrin tokë.

— Po, po, ashtu, — u hodh e tha lehtë Reizi.

— Mirë, se ashtu duhet bërë, po ama jo kështu siç thonë këta të frontit, po pse, Balli s'do t'ja ndante tokën vegjëlisë!? Po ama me mend në kokë!

Reizi ngriti gotën e rakisë dhe e ktheu njëheresh sikur të mos dinte ç'të bënte tjetër. Eqrem beu thirri me zell kamerierin e porositi përsëri.

— Kjo puna e tokës është e ngatërruar, — vazhdoi të fliste Eqrem beu. — Eh, toka! Po pse, që thua ti, gjyshi im që shkriu pasurinë e tij dhe bleu këto toka që i trashëgoj unë, pa mend në kokë ka qenë? Jo, ore, jo! Ja dinte ai vlerën asaj, ndaj dhe e bleu. Është e shenjtë toka, o Reiz! E shenjtë, dëgjje-ve!? Dhe gjënë e shenjtë ruaje e jepja ta mbajë atij që ja di vlerën. Po pse, ore Reiz, kot të mbajta ty për të m'i punuar?! Po ja, ashtu do të thuash ti. Jo, ore, jo! Se ti ja di më tepër se disa të tjerë se ku i dhemb asaj. Ndaj dhe ja ke bërë hyzmetin. Po hajde, ta kthejmë dhe një herë, — dhe Eqrem beu e ngriti gotën i pari.

Reizi e ktheu përsëri rakinë me fund dhe se si i erdhi, që Eqrem beu e kishte prerë llafin atje ku s'duhej ta priste.

— Ore, po nuk ja vlen vetëm të thuash: «dua dhe unë tokë», po duhet dhe të dish ta mbash atë. Ja ti, për shembull, e meriton të kesh një copë tokë tënden. Më është mbushur mendja se edhe ti po t'i kishe paratë si gjyshi im, që rahmet pastë, tokë dhe vetëm tokë do të blije. Kurse njerëzit sot kujtojnë se do të nxjerrin para të thata nga toka, sapo ta marrin atë. Dhe dëgjo këtu, o Reiz Huta, dëgjo këtu, se ka ardhur koha që njerëzit e mirë të shpërblehen me të mira, ndaj kam vendosur të të jap arën që bie nga ana e Fushës së agait që ta mbash e ta punosh për vete, ta mbjellësh e ta korrësh po për vete. Dëgjove? Kështu u thuaj dhe në shtëpi, se fronti e ka marrë ngadalë-ngadalë dhe jo për së mbari këtë punë. — Eqrem beu e toku gotën me Reizin dhe nisi të hante mezen me kënaqësi. Pastaj, si të qe kujtuar për diçka që duhej thënë së shpejti, ju drejtua përsëri Reizit: — Ke dëgjuar që janë ngritur malësorët e veriut dhe bëjnë luftë maleve, se s'duan që toka t'u jepet atyre që s'ja dinë kimetin?

Reiz Huta i turbulluar, ca nga llafet e beut e ca nga rakia, ja kishte ngulur sytë gotës, sikur të priste që ta shihte atje fatin e tij. «Eqrem beu zemërgjerë e dorëlëshuar, — jepte e merrte Reizi me vete, — këndeje kashtën e paratë, andej arën që bie nga Fusha e agait që e kishte kthyer vite të tëra me krahët e tij. Megjithëse të ngatërrojnë ca djelmuria që luajnë me top atje pranë, prapëseprapë është tokë. Do një të rrethuar të mirë e pastaj futju si bukëvales. . .»

— Hajde gëzuar! E u thuaj në shtëpi që këta të frontit e kanë marrë ngadalë këtë punë. Ata duan të bëjnë sipas dëshirës me tokat! — tha prapë tërë qejf Eqrem beu.

Tek kthehej për në shtëpi, Reiz Huta mendonte shumë gjëra. Gjunjët i lëkundeshin pak, po mendjen e kishte top. I dukej sikur kjo që dita më e mbarë e jetës së tij. Atij s'po i pritej sa të arrinte në shtëpi. Napolonat tani s'i hynin fare në sy. Rrugës pati qejf t'ja merrte këngës, por i erdhi si rëndë nga kalimtarët. Pastaj s'kishte dhe kush t'ja kthente. «Hajde, po ja marr në shtëpi. Atje ka kush ma kthen», — mendoi i gëzuar.

Në shtëpi gruaja u habit kur e pa ashtu, të bërë në qejf.

— Eja, grua, se do të bëhemi me tokë! — tha i kënaqur Reizi.

— Doli e uruara? — tha gruaja dhe mbeti e mbërthyer në vend nga lumturia që ndjeu. Kishte kohë që priste të vinte ky lajm i mirë.

— Cila, moj? — tha Reizi pa të keq.

— Reforma de, reforma agrare!

— Po thuaj ara, mbaje vesh mirë, grua, ara që bie nga Fusha e agait s'është më e Eqrem beut!

Gruaja mbeti e pezmatuar. Në fillim deshte të qeshte, ta shprehte gëzimin që ndjente, po dhe ajo vetë u habit që në ato çaste s'ishte e zonja të lëvizte. Mos vallë ky ishte një lajm i rremë? Kushedi! «Ky duhet të jetë i pirë» — mendoi për të shoqin.

— S'do mend. E si do të të besohet ty! Po na, merri dhe dil e bliju fëmijëve rrobe të reja! Dhe mos harro edhe veten tënde, more vesh! Kështu tha Eqrem beu, — dhe Reizi nxori napolonat nga xhepi

e ja tregoi gruas. Po asaj se si po i vinte nga këto që dëgjonte. Në jetë asnjëherë s'i kishin pëlqyer të papriturat. «Po Eqrem beu ç'hyn në këtë mes — mendoj dhe diç kish ndjerë kur nga goja e të shoqit kishte dëgjuar emrin e tij. Gjithnjë ai kishte qenë një shushunjë që i pinte mundin burrit të saj, dhe asnjëherë emri i tij s'ishte zënë në gojë për të mirë në shtëpinë e tyre. Pastaj ajo dhe në varr s'do ja harronte Eqrem beut e zonjës së tij...

I që mbushur mendja top se vajzën ja kalli në dhe Eqrem beu me të zonjën. Ja kujtonte dhe të shoqit këtë. Po ai e ngushëllonte duke thënë: «Ashtu ishte e thënë!»

Ajo e dinte mirë se, po t'i kishte dhënë beu ca para borxh, vajzën do ta kishte shpënë te doktori, do të kishin blerë ilaçet dhe s'do të qe e thëna ashtu. Vajza do të jetonte. Po zonja ishte ngrysur e tëra kur ajo kishte trokitur në derë e i kishte qarë hallin për vajzën. Dhe Eqrem beut, gjoja i kishte ardhur keq, po s'u bë njeri të nxirrte paret nga xhepi!.. Dhe ajo atëhere, kishte dalë nga shtëpia e tyre me buzë të dridhura nga dhimbja për vajzën dhe tërë urrejtje për shushunjën e zonjën e tij... Dhe ja, me sa dukej, shushunja bëri një të mirë.

— Fronti, që thua ti, grua, e ka marrë punën shtruar, siç e tha dhe Eqrem beu. Kurse kjo kockë, — dhe Reizi i ra gjoksit me grusht, — do tokë që të bëjë misër e grurë.

Gruaja vetëm mbante vesh dhe s'i erdhi mirë kur dëgjoi nga i shoqi përsëri emrin e beut.

— Hë, po ty s'të besohet! — foli prapë Reizi, po këtë herë pa gaz në buzë. — S'do mend. Kemi kaq vjet që duam një copë tokë tonën, kaq vjet që po lëmë bretkun duke punuar tokat e të tjerëve.

— Këtu ta kisha llafin dhe unë, — ndërhyri gruaja e menduar dhe u bë gati të nxirrte bukën e të shtronte drekën.

Reizi u vrejt dhe ra në mendime, siç binte shpesh kohët e fundit. «Hë, dreq o punë, — mendoj — gjithnjë janë tallur me ne të varfërit» — dhe ashtu nëpër sytë e tij të turbullt nga rakia, solli ndër mend Eqrem beun. Ehu! Ndryshe sillej ai më parë, ndryshe tani që theu qafën gjermani dhe larove të tij u vinte festja vërdallë! «Hej dreq, — shau veten nëpër dhëmbë — të dojë të më gënjejë vallë?»

Gruaja kishte lënë misërniken e ngrrohtë në sofër dhe tasin e fasuleve në mes, po mendjen s'e kishte as te fëmijët që ende s'ishin mbledhur në shtëpi, dhe as te fasulja që po ftohej. Ajo ja kishte mbërthyer sytë të shoqit që jepte e merrte me vete.

— Të kam thënë, — tha ajo me zë të paktë e të menduar, të kam thënë që s'bën mirë që s'i shkullën të gjithë njëherësh këta larot e Ballit, po i lënë sa për të na ngatërruar këmbët. Dhe mirë thoshte nënë zeza: «Nga i ligu vetëm të liga prit».

— Ku do ta nxjerrësh, grua? — tha rëndë Reizi, që ende s'po u jepte rrugë mendimeve të errëta.

Ajo s'i dha përgjegje po vazhdonte ta shihte të shoqin drejt në sy.

— Ç'të thotë mendja, mos kam bërë ndonjë poshtërsi?! — dhe Reizi i shtrëngoi fort napolonat me pëllëmbën e dorës, sa i bëri shuk. — Jo, grua, kam lindur i ndershëm dhe po me ndër do ta fus kokën në dhe. — Dhe Reizit i erdhi rëndë që u detyrua të fliste për veten. Fjalët e fundit ai i tha me zë të dredhur. Gruas ju mbushën sytë me lot.

— E paraja, paraja! — tha me zë të drithëruar

ajo. — Gjë e madhe është. Të ngatërron gjuhën, këmbët, duart..! Si shpejt e harrove meselenë e vajzës. Atëhere e drodhi Eqrem beu. Po ama vajza zuri dhenë...

Reizi s'foli, po hapi pëllëmbën e la shukun e pareve të binte mbi sofër, si për t'i thënë gruas: «Ja të shkretat».

— Pse s'ti ka dhënë këto më përpara? Pse s'të ka folur më parë për tokën? Hë, si thua? Kaq bujar të jetë bërë Eqrem beu? — tha gruaja e menduar dhe pa të shoqin me dhimshuri si për t'i thënë: «E toka, toka e shkretë! Tërë jetën je dhënë pas saj!»

— Nuk e di, nuk e di! — tha me pikëllim Reizi, — vetëm them që diç paska në këtë mes, se s'i ka luajtur gishtat tjetër herë me ne.

— E ke parë si ka ndryshuar qyshse partizanët zunë qytetin? — tha përsëri gruaja e menduar.

— Se si është bërë, — dhe Reizi u mendua t'i shkoqiste më mirë fjalët që do thoshte, — si njeri i shtirë është bërë.

— Mua më duket se i ka hyrë frika gjer në bark, — tha gruaja e vendosur.

— Ashtu duket, po prapë mbahet, — tha Reizi dhe s'e fshihte keqardhjen që Eqrem beu mbahej ende.

— Të foli gjë tjetër sot? — e pyeti gruaja e merakosur.

— Po, më foli për zgjedhjet dhe për tokën, për frontin, për luftën që akoma s'ka mbaruar maleve...

— Punë e ngatërruar, — tha gruaja me pikëllim.

Reizi tundi kokën dhe s'dinte ç'të thoshte.

— Kam frikë, — foli ngadalë ajo, — kam frikë se do na mbeten prapë fëmijët pa shkollë.

— Po fronti! — tha njëheresh Reizi, që ju duk se gjer atëhere kishte harruar të thoshte fjalë me kaq rëndësi.

— Po ja, ata janë të zot, që s'ua tremb gjë syrin dhe që kanë në dorë dhe gurin dhe arrën.

— Ndaj ta kishin nxjerrë shpejt atë të uruar reformë, — tha Reizi gjithë duf, që ju kujtua Eqrem beu, napolonat, ara nga ana e Fushës së agait — dhe atëhere ky edepsëz s'do luante kështu me ne!

— Si të jetë shkruar, — tha e merakosur gruaja — pasnesër ne do të hedhim votën tonë, po shiko se Eqrem beu s't'i ka dhënë kot këto! — dhe vështroi napolonat që kishin mbetur shuk në sofër.

Reizi mbeti gjatë pa folur. Ai filloi të sillte ndër mend gjithë jetën e tij nën thundrën e beut dhe se si ju duk kur mendoj, që kishte pirë dhe kishite bërë muhabet me të, bile kishte marrë prej tij dhe napolonat.

Reizi shfryu më në fund. — Hë, ky i madhi s'po duket. — Të vinte që t'ja kthente prapë paratë edepsëzit — dhe mori të paloste napolonat. — Shiko, shiko! Tani po i shoh mirë që e paskan bojën si të gjarpërit! Hë, ç'po më hanë duart sa t'ja kthej. Sa i di koka! Pasnesër! — më tha, — posi pasnesër për Eqrem beun e shokët e tij! — dhe Reizi qeshi me vete.

Gruaja s'bëri zë, po e kënaqur që i shoqi s'u gënjeje dot nga shushunja, doli përjashta për të thirrur fëmijët.

## MBRËMJE E SHQETËSUAR

Lumja shkonte udhës së fshatit për në shtëpi dhe gëzimi që e kishin zgjedhur nënkryetare të kooperativës bujqësore të bashkuar i pleksej me fijen e shqetësimit për përgjegjësinë e detyrës së re.

Po binte mbrëmja. Në mëngjez ishte derdhur një re kalimtare dhe e kishte njomur tokën mirë. Frynte një fllad i freskët, siç ndodh zakonisht pas ndonjë shiu pranveror.

Flokët e zinj të shpupurisë i uleshin e i ngriheshin mbi ballin e ngushtë dhe ajo ndjente fërfëritjen e tyre kur preknin qepallat e gjata. Çoi sytë të shikonte kohën: Ca re të përhimta po rrëshqisnin në sipërfaqen e bruztë të qiellit.

«Shoqet do të kenë mbërritur — mendoj — s'shkova dot me to». Ajo ishte vonuar në mbledhjen e kryesisë së re.

Lart, retë u bënë të murme dhe nisën të rrëshqisnin me ngadalë. «Eh, sikur të derdhin prapë shi» — murmuriti si me vete dhe rishmë filloi të mendonte për kooperativën, për detyrën e saj. Kishte ca që po ecte. E ndjente veten të lehtë dhe të gëzuar. Sikur gjithë natën të vazhdonte të ecte kështu,



ajo prapë s'do ta ndjente lodhjen në gjymtyrët e saj.

Po ecte bri pyllit të vogël me dru liqeri që e përdornin për kullotje. Donte dhe ca që t'i afrohej shtëpisë, kur dëgjoji një zhurmë që vinte nga bren-dësia e pyllit. Qëndroi dhe ktheu kokën andej. «Po kjo?» — mendoi. Zhurma mbeti për pak. Po ajo nuk lëvizi. «Ç'të jetë? — foli si me vete. — Mos vallë ndonjë dhi është shkëputur nga tufa dhe po kullot akoma? — Dhe i shkoi mendja te Rrapua, bariu i kooperativës. — Ej, xha Rrapo, — tundi lehtë kokën — më i kujdesur tjetër herë» — dhe u kthye e u fut në pyll. Por pak më tej i mbajti hapat prapë. Në veshët e saj erdhi e njëjta zhurmë. Një si zhër-zhër përsëritej vazhdimisht. «Jo, jo, kjo s'ka lidhje me Rrapon» — mendoi dhe e habitur kryqë-zoi krahët në krahëror. «Vërtet, ç'të jetë — mendoi — pa dale të mbaj vesh më mirë!» Dhe u mbështet pas drurit që kishte më pranë. Nuk po i përqëndron-te dot mendimet. Zhurma nisi përsëri. Herë dë-gjohej më e fortë dhe herë më e dobët. «Mos është ndonjë kafshë brejtëse? — pyeti veten. — Po prapë s'ka mundësi të dëgjohet kaq shumë!» — dhe instin-ktivisht nisi të ecte nëpër pyll andej nga vinte zhur-ma misterioze. Prapë zhurma s'u ndje. Kjo e bëri Lumen të mbante hapat e të shqetësohej. Ja, prapë filloi. Sikur rënkon pylli nga dhembjet. Po, po kësh-tu do të jetë. Si nuk e kapa që në fillim! Po tani pse heshti? Se nuk ndjen dhembje. E mora vesh. Këtë zhurmë e bën sharra e ndonjërit prej bashkëfsha-tarëve. Ja, përgjon, i jep disa herë sharrës, pastaj pushon e përgjon. Do jetë nga ata që shesin dru në qytet pa lejë. Po pse me sharrë? Të gjithë tek ne presin me sëpatë. Shiko sa shumë që ruhet! Kush

do të jetë vallë? — Dhe u mundua të kujtonte fshatarët që braktisnin ditët e punës për të çuar dru në qytet. «Mirë pa lejë, po pse të presë drurin e liqerit, drurin më të mirë, që e kemi për trupa. Gjethet e tij i përdorim në dimër për bagëtinë. Ai duhej ta dinte mirë këtë». Dhe ajo ecte me hap të matur duke patur kujdes që të mos ndihej kur shkelte në gjethet e drurët e hollë. Gomari i kundravajtësit filloi të lëvizte në vend. «Kafsha e gjorë, — mendoj ajo, — e tradhëtoi të zotin, kushedi, do jetë mërziur duke ndejtur lidhur». Fshatari goditi në kurrizin e saj të fortë. Nga mënyra se si e godiste gomarin ajo e kuptoi se kundravajtësi ishte zemëruar shumë. I qe afruar vendit, po errësira që kishte pushtuar pyllin s'e lejonte t'i dallonte gjërat mirë. Ishte tamam koha kur dielli kapërcente horizontin, dhe yjet s'ishin ndezur ende. Dy-tri bubullima gjëman, ndërsa jehona e tyre iku larg si një kollë e mbytur.

— Ush, ush... — u përhap nëpër pyll zëri i mbytur i kundravajtësit.

«Më paska diktuar, — mendoj ajo — dhe tani kërkon t'ja mbathë...»

Një fërfëritje e fuqishme u ndje në gjithë pyllin dhe ajo ndjeu sikur miliarda purteka të holla godisnin gjethet e gjelbërta të degëve të liqerit. Piklat e mëdha të shiut pranveror ranë mbi kokën dhe trupin e saj. Ajo u mbështoll më fortë me trikon e pambuktë dhe i erdhi inat që s'u tregua më e kujdesshme. «Ta kisha zënë me presh në duar» — mendoj.

— Ush — ush, — u dëgjua prapë thirrja e lodhur e kundravajtësit që po mundohej të ikte shpejt.

— Ej, qëndro! — thirri ajo gjithë ankth.

Po në vend të përgjigjes dëgjoji kërcitjen e dakut që vinte në veshët e saj e përzier me zhurmërimën e shiut. E kuptoi se ai po i largohej. Ajo nuk e dëshironte këtë, ndaj ja dha vrapit. Pak më tej sa s'u rrëzua te druri i sharruar pjesë-pjesë. «S'arriti t'i ngarkonte, — mendoi shpejt, — i ka bërë gati që t'i priste në shtëpi».

U ul për pak të shtrëngonte lidhëset e këpucëve sportive dhe nisi prapë të vraponte. Ikja e frikësuar e kundravajtësit i dha më shumë zemër. Në fillim ajo kujtoi se mund ta arrinte shpejt. Këpucët e lehta që kishte mbathur e ndihmonin të vraponte më lirisht. Por shiu që kishte nisur të binte e njomi dhe më shumë tokën e butë të pyllit. Këpucët prej llastiku rrëshqisnin mbi gjethet e lagura dhe ajo nganjëherë humbte ekuilibrin. Ndaj i mori këpucët në duar duke i ardhur keq që kundravajtësi i qe larguar. «S'më shpëton dot, sidomos në të dalë të pyllit s'ka ku të më shpëtojë» — mendoi duke vrapuar dhe s'i erdhi mirë që fshati i saj të kishte ende njerëz me zakone të tilla. «Kush do të jetë vallë?»

Drurët e dendur të pyllit i dilnin përpara sikur të donin ta pengonin. Po ajo i shmangej përplasjes me ta duke lëvizur herë majtas e herë djathtas. Gjembat i shponin këmbët e zbatthura, po ajo s'donte t'ja dinte. «Duhet arrirë para se të fshihet në shtëpinë e tij» — mendoi dhe u mundua të maste me mend vrapin e saj, thellësinë e pyllit, kohën dhe largësinë që e ndante për të dalë në fushë të hapur.

«Ç'ta këtë shtyrë, — mendoi prapë — mos vallë nevoja?! Po në kooperativën tonë s'është ankuar

ndonjë për jetesën. Pastaj dhe në kryesi s'ka ardhur ndonjë lutje për ndihmë nga fondi i kooperativës. Po atëhere. . ? !»

Gryka nisi t'i digjte. Pulpat e këmbëve ju rënduan, po ajo nuk u dha. Kundravajtësi e kishte më të lehtë, jo vetëm se ai i njihte mirë shtigjet e pyllit por edhe se shkonte kaluar. Në vrap e sipër ajo u kujtua për diçka: «Jam e pambrojtur» — mendoi dhe ndaloi, hodhi shikimin e nxituar përreth, rrëmbeu një degë që ju ndodh pranë, e pastroi shpejt nga degëzat e vogla dhe me të në dorë nisi përsëri vrapin. Për pak ajo e humbi objektin që po ndiqte, prandaj priti ca të përgjonte. Dëgjoi një britmë të mbytur. E kuptoi se kundravajtësi tani, do të kishte bërë djathtas. «Përse veproji kështu — mendoi prapë kur doli nga pylli dhe u var poshtë në drejtim të përroit, — shiko, shiko! Ka bërë nëpër përrua që të humbasë gjurmë. Po unë do ta ndjek gjer në fund». Dhe ajo ndjeu këmbët e saj të futeshin në ujin e ftohtë të përroit. Gjunjët sikur ju prenë dhe desh u rrëzua. «Oh! — gulçoi lehtë pa ditur se kujt i perkiste kjo thirrje e hidhur, kundravajtësit, ujit të ftohtë që i mpiu këmbët, apo vetes, pasi ju duk sikur e lanë energjitë. — S'e ka menduar keq. E ka bërë hesap përroin si një pengesë të pakapërcyeshme për mua. Uji i ftohtë dhe i rrjedhshëm, gurët e vegjël me lëmysk që s'mund të vësh këmbën në ta... Ndërsa ai tani kalon shaluar. Po unë s'do ta lë të ikë. — Dhe ajo doli nga përroi e u fut prapë në pyll. — Do t'i dal përpara».

Lumja vazhdonte të rendte nëpër pyll pas kundravajtësit. Dhe nuk që vetëm lodhja fizike ajo që e mundonte. Ajo ishte e bindur se ky ishte vetëm



një rast dhe s'do t'i binte më radha të drobitej kësh-tu. Tani atë e mundonte dhe diçka tjetër. «Kush do të jetë?! — mendoi. — Mos vallë ndonjë kokë-shkretë që e ka bërë ves këtë punë, apo ndoshta ndonjëri që i ka rënë halli mbi kokë, — dhe e çoi mendjen te fshatarët që i kishin thirrur në kryesi se prisnin dru pa lejë. «Vërtet, si s'më ra ndër mend për të!» — Dhe ashtu, në vrap e sipër kujtoi Jaçen që së shpejti do të martonte vajzën e madhe. «Në qoftë se është ai duhet shtuar shumë puna sqaruese me të».

Dhe ju kujtua Jaçaja, që kokëulur e pa thënë gjë kishte dalë nga mbledhja e kryesisë. Atëhere kryetari i kishte folur rëndë. Dhe asaj s'i kishte ardhur mirë nga fjalët e kryetarit. Jaçaja ishte një njeri i drojtur. Atij së shpejti do t'i lindte gruaja, gjithashtu po i afrohej dhe dasma e vajzës së madhe. Lumja u mundua të kujtonte sa fëmijë i bëheshin Jaçes, po s'mundi. Ajo vazhdonte të vraponte drejt kundravajtësit e shqetësuar.

Reja ishte zbratur dhe shiu kishte pushuar po aq befaz sa ç'kishte filluar. Errësira po dendësohej. Fustani i qullur i qe ngjitur i tëri pas trupit. Trikoja e pambuktë s'e pengonte më. Atë e kishte hequr gjatë udhës. «Do t'i ketë shkuar ndër mend se më shpëtoi, se ma hodhi me punën e përroit — mendoi — po ja dhe pak sa të dal nga pylli dhe do ta shohë veten të zënë si në lak». Pas pak ajo doli nga pylli, zbriti kodrinën e vogël prej shtufi dhe u ndal poshtë te fusha e mbjellë me grurë. Tani përroit e kishte para syve. «Në qoftë se s'ka kaluar — mendoi — këtu do ta pres. Po nëse ka dalë nga përroi e është duke ju afruar shtëpisë?..»

Dhe ajo e largoi vështrimin hetues nga përroi dhe e nguli te fusha me grurë. «Oh, — foli si me vete, — për pak më shpëtoi!» — dhe sytë e zinj i mbërtheu te një siluetë që shkonte kaluar përmes fushës. «Shiko, i paska rënë përmes grurit pa pyetur për kërcellin e shkretë» — mendoi dhe vrapoi në drejtim të tij. Fusha u errësua. Një re e zezë rrëshqiti përpara drapërit të hënës. Po kjo zgjati fare pak, se vendi u ndriçua përsëri dhe atëhere ajo ja mbërtheu sytë mirë kundravajtësit që tani vraponte në këmbë. Gomarin e kishte lënë të lirë që kështu të kishte mundësi t'i afrohej më shpejt shtëpisë. Po Lumja tani i kishte mbledhur forcat mirë dhe për dy-tri minuta u ndodh te gomari, që i lodhur kishte ulur veshët dhe përtypte kërcellët e njomë. Tek ndjeu hapat që i afroheshin, ai ngriti kokën, e pa vajzën me sytë e mëdhenj dhe si të kuptonte diçka, ngriti veshët e pëlliti fort. Kundravajtësi instinktivisht ktheu kokën prapa dhe Lumja menjëherë njohu njeriun që po ndiqte.

— Jaçe! — thirri ajo sa mundi. — Qëndro! S'të ka hije më kështu!

Kundravajtësi ndaloi. Trupi i tij i lodhur, si të kishte marrë një goditje të fortë, bëri pak përpara nga të dridhurat e gjunjëve e pastaj u step, pa ditur se ç'të bënte. Dukej i dërmuar. Ai i ndjeu hapat që vinin drejt tij dhe nisi të ecte ngadalë. Kishte dalë nga ara dhe po ngjitte të përpjetën e vogël që kishte përpara. Dheu ishte qullur dhe ai, pa e pasur mendjen te vendi ku shkelte, rrëshqiti e, tek u mundua të mbante trupin, u shemb më keq në baltën argjilore...

Ai mezi u ngrit.

— Shko, merr kafshën, se po dëmton kërcellin e njomë, — i tha ajo me zërin që i pengohej nga dihatja.

Kundravajtësi kokëulur eci drejt kafshës, e ka-pi prej kapistalli dhe e tërhoqi me forcë. Lumja po mendohej se si të sillej. E kishte në dorë ta dër-monte më keq me fjalë të rënda. «Por jo, — mendoi shpejt, — duhet të sillem ndryshe».

— Të lindi gruaja? — e pyeti me zë të qetë.

Ai s'i dha përgjigje po e tërhoqi dhe një herë rripin e kapistallit.

Ai ngriti sytë ngadalë dhe i uli përsëri me turp.

— Ta di se më hapet dheu ja këtu para syve dhe s'kthehem më në pyll. — Dhe kur kujtoi që kishte prerë në pyllin me dru liqeri, kafshoi fort buzën. — Për shpirt të nënës, — tha prapë me zë të mbytur, — ishte e para herë. Në pyllin e madh do të më shikonte roja.

«Në shpirt është i ndershëm, — mendoi Lumja, — ndaj i vjen zor të kërkojë ndihmë, i duket sikur do të kërkojë lëmshë. Por ligjet e kooperativës kanë parashikuar dhe raste të tilla, kur fshatari mbetet ngushtë».

— Shko, Jaçe, shko në shtëpi dhe i thuaj vaj-zës të ta shkruajë lutjen. Të kërkosh ndihmë në kryesi, s'është turp. Hajde, natën e mirë!



## ELEKTRICISTI I TURNIT

Maqina që shpie turnin nga qyteti për në hidrocentral, po ngjitet ngadalë rrugës së hapur faqe kodrave të larta e të gjelbëruara në verilindje të qytetit. Dëgjohet uturima e motorit të vjetër të maqinës që duket sikur kollitet nga e përpjeta plot kthesa. Brenda, përveç shoferit, janë ulur dhe të dy punëtorët e turnit të pasdites. Përgjegjësi i turnit është një djalë i shëndetshëm me ca sy të qetë e të thellë që të bën të mendosh se çdo gjë në jetën e tij tridhjetë e ca vjeçare ka vajtur mirë. Ndërsa ndihmësi i tij është një djalosh me flokë të zinj të ndarë me një vizë anash, i cili ka pak muaj që është kthyer nga ushtria dhe që i pëlqen shumë profesioni i elektrikistit. Ai rri prapa tyre i heshtur dhe i menduar, duke mbajtur sytë të mbërthyer te xhami i përparmë. Në një kthesë të fortë shoferi i bie fort borisë disa herë dhe maqina del në faqen e Linzës. Prej këtej pamja është mjaft e gjerë.

— Po këta, — foli shoferi që e mban kokën të zgjatur përpara, — sot e kanë gjetur ditën t'i ngjiten Dajtit?

— Janë të vendosur dhe mirë e kanë, — ja

ktheu përgjegjësi duke vështruar vargun e gjatë të ekskursionistëve. — Moshatarët e tyre e kanë shpuar Dajtin mes për mes me tunel. Dhe Dajtin vetëm thua ti! Jo ore, po dhe tri male të tjera si ai.

Ndihmësi, mendueshëm, e treti vështrimin te vargu i gjatë që po ecte anës rrugës dhe mundohej të sillte diçka ndër mend, po dialogu që zhvillohej midis shoferit dhe përgjegjësit ja ngatërronte mendimet.

— More po qenkan shumë! Si do t'i zërë të gjithë ndërtesa e kampit? — pyeti me habi shoferi duke mbajtur fort timonin dhe duke ecur ngadalë përbri tyre.

— Të nxënë the! — ja ktheu me të qeshur përgjegjësi — kot merakosesh ti, se e bëjnë me turne.

— Si e bëjnë me turne? — pyeti i habitur shoferi, që e mori shakanë për të vërtetë.

— Po ja, — e vazhdoi shakanë përgjegjësi, — gjysma kërcen e dëfren në sallën e madhe poshtë, kurse gjysma tjetër shkon e ja këput gjumit nëpër fjetoret lart. Pastaj ndërrohen...

— Tani po tallesh, — tha shoferi, që vazhdonte t'i shihte me dashamirësi të rinjtë e shumtë, të cilët me nga një çantë në shpinë ecnin ngadalë anës rrugës.

Ndërkohë ndihmësi kishte afruar fytyrën pranë xhamit të derës dhe vështronte me kërshtëri përjashta. Për një çast ai e largoi fytyrën shpejt nga xhami, si për t'u mbrojtur se mos ndokush e pikaste nga rruga. Dhe pastaj, mbasi maqina la prapa vargun e gjatë të ekskursionistëve, vështronte peisa-

zhin e gjelbër pa e pasur mendjen te biseda e shoferit me përgjegjës. Maqina tani po zbriste nëpër të tatëpjetën e rrugës që të çonte në hidrocentral.

Mbas pak shoferi frenoi përpara tunelit dhe të dy punëtorët zbritën nga maqina. Përgjegjësi i turnit e çoi kokën lart dhe u vrejti në fytyrë. Re të shumta si shtëllunga të mëdha e të zeza varehin poshtë nga majat e malit duke nderë nëpër kodrat dhe fushat përreth hijen e tyre të zymtë. Majë kodrave ishte dyndyr një mjegull e përhimtë, që bënte të ngrihej lart, ndërsa retë e zeza të ngarkuara me shi i peshonin nga sipër dhe atëhere ajo shtypej e sprapsej duke shpërndarë gjithkund masën e saj të lagësht.

— Sot do të kemi shkarkime të forta rrufesh,  
— foli si me vete përgjegjësi i turnit.

Ndihmësi pohoi me kokë përsëri duke e pasur mendjen gjetkë.

Turni u ndërrua. Maqina mori përsëri rrugën për në qytet, ndërsa brenda tunelit, në sallën e komandës të dy punëtorët morën detyrën.

Gjatë orëve të para të pasdites përgjegjësi provoi disa herë të hynte në bisedë me shokun e tij të turnit. Po ja që ndihmësi, që ishte përherë i hedhur e i qeshur, sot ishte i heshtur. Diçka e shqetësonte atë vazhdimisht.

«Si m'i tha ato fjalë aq prerë?! Si, unë s'paskam besim tek e fejuara, te dashuria ime? Mos vallë sjellja ime pa takt, në ndonjë rast, e ka cënuar më parë sedrën e saj dhe ajo i tha ato fjalë si për t'u mbrojtur? Po në qoftë se unë kam arritur gjer atje, sa të mos kem besim tek ajo, atëhere nuk ka më kuptim as miqësia jonë, nuk duhet të bëhet reali-

tet as ëndrra jonë e bukur për të ardhmen... Vërtet që para ca ditësh e qortova, por me të drejtë. Ajo kishte shkuar vetëm në mbrëmjen e fabrikës. Mua më qëlloi të isha në punë, po ajo duhej të më kishte lajmëruar më parë që të kisha mundësi të ndërroja turnin dhe të shkonim së bashku. Ky mund të ishte një rast. Po harroi ajo që sapo ka dalë nga bankat e shkollës dhe që është e re në atë fabrikë! Pastaj, se mos janë të gjithë njerëzit njëlloj! Psenuk paska dhe në punën e saj nga ata që kanë qejf t'i thonë gjërat si t'u vijë për mbarë? Po ajo e mori për ters qortimin tim, dhe ma ktheu «ti s'i njuh mirë shokët dhe shoqet e mia të punës... S'më ke njohur ende mirë... S'ke besim tek unë...» Pastaj u grindëm dhe i mbajtëm për ca ditë inat njëri-tjetrit. Dhe mbrëmë, pasi ecëm gjatë pa shkëmbyer fjalë si zakonisht, më tha se sot bashkë me të rinjtë e tjerë të qytetit, do të shkonte dhe ajo në ekskursion me shokët e shoqet e qendrës së punës të saj. Ç'ti thoja!? Të grindesha prapë? Ndoshta ajo prishte ta qortoja, po unë s'e bëra atë. Ne kishim ditë pa u takuar, ndaj u ndamë të heshtur dhe të shqetësuar...»

Shigjetat e aparateve matëse kërcyen deri në fund dhe u kthyen si të penduarë po atje ku kishin qenë. Të dy punëtorët e turnit u ngritën, të gatshëm, në këmbë. S' kaloi pak dhe shigjetat e zeza i tronditi dhe një kolpo tjetër e fortë.

— Filluan rrufetë, — tha përgjegjësi.

Ndihmësi tundi nja dy herë kokën pa i ndarë sytë nga aparatet matëse.

Ra zilja e telefonit dhe përgjegjësi ngriti menjëherë dorezën:

— Alo! Si, ju janë prerë dritat? Hej, ç'bela! Mirë more shok, mos folë aq fort! E dimë që ka ekskursionistë. Po ta kemi difektin këtu pranë do t'ju japim tension shpejt. Përndryshe do të lajmërojmë ata të shërbimit elektrik të qytetit, — dhe përgjegjësi, uli dorezën në vend e ju kthye ndihmësit:

— Ata të Dajtit lajmërojnë se u është ndërprerë tensioni.

Ndihmësi rrudhi ballin dhe tha:

— Po shkoj përjashta të kontrolloj sigurecat e linjës.

— Mirë, po me mend në kokë, — e thumboi përgjegjësi.

Ndihmësi ju afrua dollapit, mori prej andej mushamanë, dorezat, elektrikun e dorës dhe doli me të shpejtë përjashta. Për nja dhjetë minuta ai u muar me sigurecat dhe, kur erdhi brenda, mushamaja e zezë e lagur reflektonte dritat e forta të sallës dhe kullonte rrëkera të vogla uji nga cepat e saj.

— Sigurecat ishin në rregull, — tha ai.

— Atëhere duhen lajmëruar ata të qytetit që të nisen për të kontrolluar linjën.

Ndihmësi uli sytë, siç bëjnë zakonisht njerëzit kur rrahin mendjen për të marrë një vendim të prerë dhe tha me një zë lutës:

— Në qoftë se ke besim, më lejo të shkoj dhe ta kërkoj unë difektin.

— Është kohë shumë e keqe, — tha përgjegjësi.

— Më lejo të shkoj, — nguli këmbë ai në kërkesën e tij.

— Po ti dukesh i shqetësuar, — i tha me sinqeritet përgjegjësi.

Ndihmësi i uli prapë sytë, po këtë radhë si i turpëruar nga përgjegjësi që foli aq hapur.

— Ata atje janë me qindra, — u mundua të justifikohej ai.

— Do ta kesh vështirë. Ja ku po ta them unë, që s'është dhe aq e lehtë sa kujton ti, — i tha përgjegjësi me një ton serioz.

Ndihmësi nuk e ngriti vështrimin dhe rrinte si i fyer.

— Mirë atëhere, nisu, por gjithnjë me mend në kokë, — i tha përgjegjësi dhe mbylli automatikun e linjës së Dajtit. Ja, shiko, nuk do ta kyç pa ardhur ti.

Ndihmësi mori veglat që i duheshin, hodhi kambalecat në krah dhe doli përsëri përjashta.

Në sfondin e zi të natës shiu derdhej pareshtur dhe të bëhej sikur nga qielli varehin vazhdimisht miliarda litarë të hollë, të përhimtë. Ndihmësi hodhi kapuçin në kokë e nisi të ecte në drejtim të shtyllës së parë të linjës. Elektri i vogël që mbante në dorë, depëronte me dritën e tij të fortë nëpër litarët e ujshëm të shiut. Djali që orientohej me vështirësi çante rrugën duke kapur me duar degët e dru-rëve të mareve dhe bënte përpara me hapat e tij të mëdhenj e të nxituar. Era që i frynte përballë i përplaste në fytyrë pikat e rrëmbyera të shiut dhe ai përherë e më shpesh i fshinte ato me pëllëmbën e hapur. Elektri i dorës e mbante herë poshtë, për të parë vendin nga do të shkelte, dhe herë e ngrinte lart për të kontrolluar telat e linjës se mos ishin këputur apo ngatërruar me njëri-tjetrin.

Në fillim ai eci nëpër pyllin e dendur me shkur-re mareje. Pastaj doli në një terren shkëmbor.

Tani i hidhte këmbët përpara më me kujdes, se pak t'i rrëshqiste këmba dhe mund të shembej poshtë në përroin që sillte nga shpatet e pjerrëta ujët e rrëmbyer, zhurma e të cilit vinte gjer në veshët e tij si një jehonë e mbytur. Më tej linja shkonte përsipër tubacioneve të ujit, që zbrisnin nga baseni i ndërtuar pak më poshtë se rruga e cila të shpinte në ndërtesën e kampit. Nga pjerrësia e madhe e tubave ai e kuptoi se kishte mbërritur afër grykës së malit dhe se deri tani kishte kontrolluar pjesën më të madhe të linjës. Kërkimi nga çasti në çast për të gjetur difektin, dëshira për t'u ndriçuar sa më parë ndërtesa e kampit, e bënë që të mos e ndjente lodhjen dhe vetminë në mes errësirës pafund dhe ftohtësisë së shkëmbinjve të zymtë. Gjatë gjithë rrugës ai kishte ndjerë vetëm trokitjen e vazhdueshme të shiut që binte e binte mbi mushamanë e zezë si vetë nata dhe shkrepëtimat e rrepta e të frikshme të rrufeve, që i bëhej sikur do ta qëllonin atë nga çasti në çast.

Tani ai kishte përpara pjesën më të vështirë të rrugës, një të përpjetë të madhe. Vende-vende ku ngjitja qe shumë e vështirë ai filloi të përdorte edhe duart.

Kur mbërriti lart, u kujtua se në këtë zonë linjën s'e kishte kontrolluar siç duhej. Mendoi një herë të zbriste prapë, por e largoi shpejt këtë mendim. Zbritja dhe ngjitja përsëri do t'i hanin shumë kohë dhe veten do ta rrezikonte më shumë.

«Në qoftë se defekti është atje, në të kthyer, do ta rregulloj», — mendoi dhe hodhi hapat e rënduar nga çizmet dhe lodhja në dheun e lagur të fushës së Dajtit. Linja këtu shkonte buzë rrugës

së shtruar me asfalt dhe ai e kishte të lehtë të kontrollonte dhe ato pak shtylla që i kishin mbetur. Ndhimësi hodhi kambalecat në supin tjetër dhe nisi të ecte.

«Ti sikur s'ke shumë besim tek unë!» — Kështu më tha si pa të keq. Kushedi sonte mund të mendojë se mos unë kam bërë ndonjë marifet në central për t'i lënë ata pa dritë. Pse s'ma tha troç: «Ti mor djalë, kohët e fundit ke filluar të bëhesh xheloz, po ma thotë ndryshe. E të bëhesh xheloz do të thotë të arrish deri atje sa të bësh vërtet ndonjë marifet; që t'i lësh pa drita, e pastaj pa kërcyer, pa qeshur...

Po unë kurrë s'do ta bëj këtë. . .»

Ndërkohë ai ndjeu se po shkelte mbi telat e këputur që kishin rënë nga shtylla në barin e rritur të fushës.

Ndhimësi mori frymë thellë, ktheu sytë nga ana e kampit dhe ndjeu se veshët e tij të lodhur nga zhurma monotone e shiut dhe gjënimet e forta të shkrepëtimitave kapën një melodi, një si këngë që vinte andej nga ndërtesa e madhe.

«Këndojnë, — tha me vete, — bashkë me ta këndon dhe ajo» mendoi dhe rregulloi shpejt kambalecat, nxori pincat, u ngjit në shtyllë dhe filloi nga puna.

Shiu vazhdonte të binte pareshtur. Rrufetë vazhdonin të qëllonin pemët e larta dhe shkrepat. Gjënimet e tyre ai i dëgjonte të iknin diku larg. Po tani ai s'druhej nga asgjë. Kënga që vinte prej andej e bënte të fortë. Dhe atij ju kujtua përgjegjësi, shoku i punës. Si e kishte harruar atë gjer tani?!

«Me siguri, — mendoi ai, — do të më ketë ndjekur me mend gjatë gjithë kohës që unë kam udhëtuar.»



Ndihmësi tani po ecte rrugës së asfaltuar. Shiu me zhurmërimën e tij të vazhdueshme e nanuriste lehtë. Gjënimet e bubullimave të kësaj nate, i bëheshin si dam-dumet e një daulleje që dukej sikur jehonte andej nga duhej të ishte kampi. Me një ndjenjë të këtillë përbrenda qenjes së tij, ai ecte dhe i afrohej gjithnjë e më shumë ndërtesës së kampit. Në vesh i erdhën jone këngësh që ai filloi t'i mërmëronte lehtë ndër buzë. Tingujt tani dëgjoheshin të plotë dhe ai e kuptoi se ishte në bërnylin e fundit të rrugës që shkonte në mes të disa plepave të rinj shtatlartë.

Përpara syve të tij, si një anije që lundronte në një det të shqetësuar, ju shfaq ndërtesa e madhe e kampit, me ca drita të mekura nëpër dritaret e shumta. Brenda këndohej një këngë nga të kohës së luftës.

Ndihmësi ngjiti shkallët e jashtme, ndaloi te hyrja, la atje këmbalecat e mushamanë, hyri brenda dhe i hodhi një vështrim rretheqark sallës së madhe. Të rinjtë ekskursionistë kishin qëndruar grupe-grupe pranë kaloriferëve dhe këndonin. Ndihmësit i ndritën sytë nga gëzimi.

«Sa mirë qenka këtu»! — mendoi, dhe u mundua të dallonte midis ekskursionistëve të tjerë të fejuarën e tij. Po salla ishte e gjatë dhe dritat e pakta të llambave me vajguri, s'të lejonin ta hetojë mirë gjer në fund. Ai donte ta shihte të fejuarën të gëzuar, ashtu siç ishte dhe vetë në ato çaste. Po s'e pa. U kthye dhe ngjiti shkallët që të çonin te dhoma ku ishte telefoni, trokiti në derë, dhe u përshendet me ata që ndodheshin atje.

— Jam elektrikisti i hidocentralit, — u tha atyre që po e shikonin me kureshtje.

— E, si vajti puna? — e pyetën ata njëherësh.

— Në rregull, — u përgjegj ndihmësi.

— Domethënë se dritat do të vijnë, — foli njëri nga ata për t'u siguruar mirë.

— Ja tani do t'ju vijnë, — tha ndihmësi dhe ngriti dorezën e telefonit.

Ata në fillim diç pëshpëritën ndërmjet tyre dhe pastaj heshtën.

— Jo, — e kundërshtoi ndihmësi përgjegjës, që e kishte urdhëruar të qëndronte e ta kalonte natën në kamp, — nuk mundem të qëndroj.

Të pranishmit në dhomën e telefonit ja kishin mbërthyer sytë ndihmësit që po vazhdonte të ngul-te këmbë në kundërshtimin e tij.

— Jo pra, nuk munda të qëndroj. E di që është më mirë për mua, por ja që s'duhet të qëndroj.

Ndihmësi heshti për një çast duke e mbajtur dorezën e telefonit të shtrënguar dhe foli prapë:

— Nuk jam dhe aq i lodhur. E kam vendosur që të zbres. Nuk e kam nga kokëfortësia, por ja që ashtu duhet, — dhe e uli dorezën e telefonit.

— Po ti, rri me ne sonte këtu! — tha drejtori i kampit.

— S'do ta ndjesh veten të huaj midis nesh, — tha me një zë miqësor tjetri.

— S'ka arësye përse të zbresësh në këtë natë të errët dhe me shi, — foli i treti.

— Në qoftë se s'do të rrish në sallën poshtë, — tha përsëri drejtori i kampit, — atëhere hajde të të japim një dhomë ku të shtrihesh e të pushosh.

— Ju falem nderit! Më besoni se nuk e kam për kokëfortësi, — tha ndihmësi, u përshëndet me ta miqësisht e zbriti shkallët e shumta, veshi mu-

shamanë, rregulloi këmbalecat mbi sup dhe doli në rrugë. Mbas pak ai dëgjoi «urranë» e fortë të ekskursionistëve, që thirrën nga gëzimi. Dritaret e të gjitha kateve u mbushën me dritë dhe atij ju bë sikur një anije vigane që mbartte qindra të rinj që këndonin të gëzuar kishte hedhur spirancën në këtë gji të vetmuar. Dhe atij ju bë sikur midis gjithë zërave dalloi zërin e çiltër të saj.

— Mirë u pafshim nesër! — pëshpëriti.

## AJO QESHI ME GJITHË ZEMËR

Mësuesja shtyu derën, ju afrua gardhit që ndante shkollën nga rruga automobilistike, u mbështet pas tij, afroi çantën pranë kraharonit dhe kryqëzoi krahët mbi të.

Që larg u dëgjua zhurma e një maqine dhe mësuesja e drejtoi shikimin andej. Dritat e maqinës si dy zjarre shpuan errësirën. Ajo nisi të shoqëronte me sy dritat që herë zhdukeshin nëpër kthesa e herë shfaqeshin. Maqina tani po zbriste kodrën në të majtë të shkollës dhe po afrohej. . . Ajo nxori dorën dhe shoferi, një djalosh i ri, që mbante një kasketë lëkure në kokë frenoi, pastaj ngriti duart si për t'i thënë: «E shikon dhe vetë që vendet i kam të zëna». Pastaj ai nxori kokën nga xhami i ulur i kabinës dhe i foli mësueses me zërin e tij të matur:

— Prapa meje vjen Astriti. — Ndoshta të merr,  
— dhe u nis përsëri për udhë.

Asaj se si i erdhi kur dëgjoi emrin e tij. «S'e përmendi pa shkak, — mendoi, — duket që dhe shokët e dinë historinë e fejesës».

Astriti, që kur kishte marrë përgjigje nga babai i saj s'e kishte ndaluar më maqinën për të. Po



tani a do ta merrte ai vallë? Ajo u mundua t'i largonte kujtimet, ndaj ktheu kokën dhe si me turp largoi sytë nga rruga. Një rrymë e ngrohtë gjaku i përshkoi trupin dhe ajo ndjeu se mollëzat e faqeve ju ngrohën. Përse u zu aq ngushtë? «Vërtet kam faj unë në lidhje me përgjigjen e babait? Po atij kushedi se si i vjen kur ndodhet pranë shokëve që e dinë këtë histori!» — mendoi dhe ndërkohë ndjeu keqardhje për të dhe inat me veten e saj; pastaj inat për të dhe..

Por dritat e forta që ndriçuan për një çast rru-

gën ja këputën mendimin në mes. Ajo e ndjeu se maqina kishte arritur te kthesa e fundit, ndaj e mbajti kokën të drejtuar andej nga dëgjohej zhurma e maqinës, ndërsa për t'ju shmangur mendimeve që po e ngacmonin, i çoi sytë tutje nga fshati. Dritat e ndezura të fshatit të grumbulluara në luginë ju dukën atë çast si një prush i madh që i ngrohte faqet e errësuarat të të dyja kodrave të larta.

Maqina sa më tepër afrohej, aq më shumë ngadalësonte shpejtësinë. Shoferi frenoi një herë, pastaj u nis dhe pak më tej frenoi sërish e nisi të ecte mbrapsht. Dhe asaj i erdhi mirë që maqina ndaloi pranë saj. Dera e kabinës u hap ngadalë si me përtim. Mësuesja në fillim u step, po pastaj, si e shtyrë nga diçka që as vetë s'po e kuptonte, ktheu kokën dhe sypërdhe hipi lart u ul mbi ndenjësën e butë dhe s'guxoi ta çonte kokën menjëherë. Mollëzat e faqeve ju ngrohën përsëri, dhe ajo e la kokën të pushonte mbi kraharror. Gjithmonë para njeriut që qëndronte në krahun e saj kishte pasur dobësi. Edhe kur kishin qenë në një klasë, në ekipin e gjimnastikës së shkollës, edhe kur e ndeshte në rrugë a në maqinë, ajo gjithmonë u qe shmangur vështrimeve të tij.

«S'është mirë kështu» — mendoi dhe i dha kokës përpara. Tani sytë e saj të kaltër vështronin rrugën, ndërsa flokët e verdhë kontrastonin me fustanin blu me viza të bardha që mbulonte supet e saj të ngritura. Ajo si për t'u çliruar nga ndjenja që e kishte kapur, afroi çantën para gjunjëve, nxori prej andej një triko blu të punuar hollë dhe e hodhi krahëve. Shoferi ktheu kokën dhe me një vështrim të butë e soditi si për t'i thënë: «Sa e mirë që je».

Kaloi pak kohë ashtu derisa ajo i hodhi vështrimin e parë dhe, duke ulur sytë e saj të kthjellët tha me zë të paktë:

— Sa vonë!

Ai u turbullua, seç murmuriti nën buzë, dhe si për ta justifikuar veten që kishte mbetur ende pa e nisur maqinën, rrëmbeu xhaketën që e kishte të varur prapa dhe e veshi shpejt. Pastaj ndërroi marshet dhe maqina u nis.

Ai s'ja ndante sytë rrugës. Duart e tij leshtore e kishin mbërthyer rrethin e timonit, po ishin të pasigurta, si të atij që nget për të parën herë maqinën. Ajo e kuptoi se ai ishte i shqetësuar, se shkaktare për këtë ishte ajo vetë, ndaj i erdhi mirë. Pastaj u kujtua që edhe në shkollë, kur ajo i afrohej dhe e pyeste për ndonjë gjë që kishte lidhje me mësimin, ai zihej ngushtë. Dhe duke kujtuar kohën e shkollës e solli ndër mend ashtu siç kishte qenë...

Ai dallohej nga nxënësit e tjerë nga trupi i bëshëm. Nga viti i tretë ai kishte filluar të rrinte veças nga shokët, sikur ruhej se mos u zbulonte atyre një të fshehtë që s'duhej ta dinin.

Mësuesja buzëqeshi lehtë, siç bën njeriu kur kujton diçka që e kënaq dhe duke lidhur duart mbi gjunjë e pyeti:

— Sa kohë t'u bënë në punë?

Ai i liroi pak gishtat nga timoni dhe foli si me vete:

— Një vit para se të merrje maturën ti.

— Pse s'prite edhe ti ta mbaroje shkollën?

— Ja ashtu. Ti e di. Atëhere martova motrën.

Babai hyri në borxhe. Unë duhej ta ndihmoja babanë...

— Po vërtet, — belbëzoi ajo. — Atëhere u fol diçka për ty. Po unë s'i besoja kësaj. Mendoja se diçka tjetër të shtyu ta lije maturën.

— E çfarë tjetër? — pyeti me ngut ai dhe e ngadalësoi shpejtësinë.

— Ja, mendoja se të ishte mërzhitur shkolla, dhe se e ndjeje veten si të huaj midis shokëve të klasës.

Ai ktheu kokën dhe i hodhi një shikim qortues, si për t'i thënë: «S'ke bërë mirë që ke menduar kështu për mua — tha dhe përsëri pa nga rruga. Tani përballë tyre po vinte një maqinë. U shuan dhe u ndezën dritat, maqinat u takuan dhe shofe-rët ngritën dorën për të përshendetur njeri-tjetritin.

— Po ti e mbarove institutin? — e pyeti ai prerë.

— Më kanë mbetur edhe provimet e fundit për të dhënë, — foli shpejt ajo, si për të mos u dhënë shumë rëndësi fjalëve që tha dhe shtoi: — Po tani a merresh me gjimnastikë?

— Të kisha kohë do të merresha me të dyja, — tha ai dhe i shtrëngoi prapë gishtat në rrethin e timonit. — Po ama shkollën s'e lë pa e mbaruar.

Ajo kafshoi lehtë buzën e poshtme dhe i çoi sytë e kaltër tej xhamit të përparmë. Jashtë frynte një fillad i freskët që lëvizte gjethet e drurëve anës rrugës, ndërsa fashat e dritave shtriheshin gjer tej duke i bërë të shquheshin edhe më mirë drurët shtatlartë që mbushnin vendin përreth. Lart, drita e yjeve shembëllente me sumbulla të arta të qëndisura në copën e errët të qiellit.

Maqina ecte me shpejtësi dhe mësuesja ndjente ajrin e freskët që hynte lart nga xhami i hapur, që



i shpupuriste flokët rreth ballit. Ajo kishte dëgjuar për të që punonte shumë.

— Si ju pëlqen të udhëtoni juve shoferave, natën apo ditën? — e pyeti ajo, si për ta lehtësuar djalin që vazhdonte të shtrëngonte fort timonin.

— Për këtë duhet të pyesësh të gjithë shoferët. Mua, për shembull më tepër më pëlqen kur udhëtojnë natën, — tha ai duke mos e kthyer kokën nga vajza.

— Pse kështu? — e pyeti çiltër ajo.

— Në fillim s'më pëlqente. Më bëhej sikur do të më ndodhte ndonjë e keqe që unë e prisja nga nata në natë.

— Po pastaj? — u bë kureshtare ajo.

— Tani ndodh krejt ndryshe. U mësova!

— Dhe të pëlqen sidomos kur ke udhëtare pranë, — ndërhyri ajo duke e parë djalin tashmë me kurajë.

Ai si dha përgjegje shpejt, po shtrëngoi nofullat dhe i tendosi krahët mbi timon me nervozizëm.

— Është interesante një gjë. Për ne shoferët kanë menduar dhe kanë folur keq. Ajo që na habit dhe na rëndon është se akoma i fryjnë këtij avazi, — tha me zë të vrazhdë ai duke vazhduar të shikonte tej xhamit të përparmë.

— Nuk është ashtu — e kundërshtoi ajo.

— Dhe arrijnë deri atje, — ngulmoi ai, — sa çdo gjë që s'u pëlqen e krahasojnë me «sjellje prej shoferi», thonë: «jetë shoferi». «e panë me një shofer...»

— Nuk është pra ashtu — nguli këmbë ajo.

— Të gjitha këto për ne shoferët...

— Dhe këto gjykon ti se i shkoj nëpër mend

edhe unë, një mësuese e re, që i njeh mirë dertet e shoferëve të këtyre anëve, që njeh dëshirën e tyre të madhe për rrugët, për timonin, që njeh lodhjen, pagjumësinë e tyre dhe gëzimin kur maqina u shkon mirë e ngarkesa lart mbërrin shpejt në vendin e caktuar, që njeh dashurinë e tyre të sigurtë për shokun dhe...

— Zamira! —tha ai me zërin e ngritur.

Përsëri përballë maqinës së tyre u shfaqën dy drita të forta. Përsëri shuarje e ndezje dritash, maqina që kalojnë pranë njëra-tjetrës, ngritje të dorës dhe tundje të lehtë të kokës së shoferit që po vinte përballë dhe përsëri zëri i saj:

— Po unë si s'të njoha ashtu siç desha?!

U ndërruan marshet, frenat u shtypën dhe maqina ndaloi ngadalë. Shoferi ktheu kokën me vështrim pyetës, u mat të nxirrte ca fjalë po s'mundi dot. Tani ai ishte i zoti vetëm për t'i lëvizur prapë marshet si një njeri që vetëm këtë gjë di të bëjë. Mbasia e pa atë, për t'u bindur nëse fliste sinqerisht, e pyeti me zë të ulët, siç i ndodh çdo njeriu kur flet për çështje që peshojnë:

— Qysh kur kështu?

— Që në gjimnaz — pohoi ajo me sinqeritet.

Ai frenoi përsëri duke u mbajtur fort pas timonit, ndërsa trupi dhe koka e saj me leshrat e verdha u përplasën pas te mbështetja e sediljes. Ai tani ishte kthyer i tëri nga ajo si për ta pyetur: «Ej, a erdhe në vete tani? Dhe nëse e ke mbledhur vërtet mendjen, përgjigju drejt».

— Dhe atëhere si të dukesh? — i foli ai me zërin që i dridhej pak nga kërshtëria.

— Si një djalë që i pëlqen vetja, — ja ktheu ajo me zërin e saj të plotë, e bindur për atë që po fliste, — dhe gjithmonë ai, të cilit i pëlqen vetja s'vonon dhe bie në gabime.

— Vërtet, — pranoi ai duke kaluar dorën te flokët e dendur, — atëhere se si më dukej. Druhesha nga të tjerët. Ndaj shpesh mbyllesha në vetëvete në kohën kur kisha nevojë të bisedoja me dikë tjetër. Pyesja e merrja përgjegje nga vetja atëhere kur kisha shumë dëshirë të pyesja e të merrja përgjegje nga dikush tjetër. «Nuk do të më kuptojë, — më thoshte mendja atëhere, — kushedi ç'do mendojë më pas për mua? Do ta bisedojë me shoqet, e shoqet me shoqe të tjera dhe hajde e rri më gjatë në shkollë». — Po pastaj? — pyeti ai më tej me zë lutës.

— Pastaj mendova si gjithë shokët e tjerë të klasës.

— E çfarë? — e pyeti ai me padurim.

— Se ti na dole një njeri ndryshe nga ç'të kujtonim.

Ai uli kokën siç bën i pandehuri kur e pranon akuzën që i drejtohet.

— Po më vonë? — pyeti ai mendueshëm.

— Tani mjaft! Ti vetëm kërkon të dish nga të tjerët. Shiko se ke ndaluar në kthesë!

Ajo e kafshoi përsëri buzën e poshtme dhe ndjeu se ashtu padashur kishte goditur thellë në shpirtin e tij, një njeri që s'duhej ta godiste.

— Megjithatë, — shtoi ai vrazhdë, — ja po të bindem, — dhe i dha gazit.

Maqina luajti nga vendi dhe bëri përpara. Po tani ajo shkonte rrugës ngadalë, si e ngarkuar shu-

më rëndë. Mësuesja s'dinte ku ta ndalte vështrimin e saj të shqetësuar. Gishtërinjtë i lëvizte nëpër rripat e çantës që e mbante mbi gjunjë dhe një ndjenjë e lehtë keqardhjeje i përshkoi tejmbanë kraharorin. U mat një herë t'i fliste më hapur, po e mbajti veten. «Jo, — mendoj — duhet që vetë t'i kuptojë të gjitha. . .» Ajo prapë vazhdonte të lëvizte gishtërinjtë e hollë nëpër rripin e çantës. Ai, në fillim s'ja ndau sytë rrugës, po pastaj i shtyrë nga dëshira për ta prekur në sedër, i foli ngadalë dhe me ton serioz:

— Si nuk druhesh! Je vetëm për vetëm me një shofer, natën, në një rrugë të largët!

— Oh, — tha ajo shpejt, unë kam besim tek njerëzit që njoh.

Maqina vazhdonte të shkonte ngadalë, si e ngarkuar rëndë.

— Të them të drejtën, Zamira, — u mundua të justifikohet ai, që s'e priste këtë qortim, — me ty e ndjej veten ngushtë, që atëhere kur babai yt, duke u nisur nga profesioni im kundërshtoi kërkesën time për t'u fejuar me ty.

Ajo kishte kafshuar thoin e gishtit të madh dhe mundohej të shkoqiste fjalët që duhej t'i thoshte:

— Babai nuk hyn në këtë mes, — tha ajo më pas. — Ai është prind dhe kishte të drejtë të merrte pëlqimin tim, e pastaj t'i jepte përgjegjen shkesit që shkeli në prakun e shtëpisë sonë.

Një shytë po vinte prapa maqinës sonë që s'po ecte dot shpejt. Shoferi i shytës i ra disa herë bori-së si për t'i thënë kolegut: «Hej, vëllaçko, me se do të të ndihmoj». Pastaj e ngadalësoi shpejtësinë dhe duke kaluar bri nesh, hodhi shikimin miqësor nga

kabina, tundi nja dy herë kokën dhe buzëqeshi.

— Ashtu pra, — foli ai, — nuk paska qenë siç mendoja unë?

— Nuk kishte si të ishte ashtu. Unë jam një mësuese e re dhe unë nuk mund të bëj ndryshe nga ç'edukoj e bind të tjerët.

Ai as foli dhe as i luajti qepallat.

— Mirë pra, — vazhdoi ajo. — T'u mbush mendja vetë ose ta mbushën të tjerët për të më kërkuar mua. Dhe s'të shkoi fare ndër mend se unë mund të isha...

— Si? — pyeti ai gjithë ankth.

— Që mund të dashuroja ndonjë tjetër.

— Kjo nuk është e vërtetë, — u hodh e tha shpejt ai dhe i hodhi grushtet me forcë mbi timon. — Kush është ai tjetri? — tha rreptë ai duke vazhduar ta mbante dorën grusht.

Në buzët e mësueses së re çeli një buzëqeshje e çiltër.

— Po atëhere pse u drejtove direkt te babai dhe nuk bisedove një herë me mua?

— Me këto profecira më turpërove përpara shokëve dhe të afërmëve të mi. Dhe tani po vazhdon të më shtysh dhe më në buzë të greminës duke dashur të luash me ndjenjën time. Mirë pra! Në djall të vejë ëndrra ime, — dhe lëvizzi dorezën e marshit e me nervozizëm i mëshoi gazit.

— Astrit! — thirri ajo e shqetësuar.

Po ai tani kishte mbërthyer përsëri sytë te xhami i përparmë.

— Astrit! — thirri prapë ajo me zë më të fortë.

Ai ngriti pak kokën e rënduar dhe e vështroi. Kraharori i saj ulej e hidhej përpjetë, sytë e kaltër

u mbërthyen mbi të tijët, buzët i ngjanin me dy fletëza manushaqeje që dridhen lehtë kur flladiten nga puhia e mëngjezit, ndërsa duart po i mbante të shtrënguara në krahun e tij.

— Përse? — tha ai me zërin e tij të mekur si i zgjuar papritur nga një ëndërr.

— Oh, je një njeri... desha të them një djalë, i çiltër ndaj të kam pasur përherë në mendje.

Ai frenoi, kapi duart e saj dhe i mblodhi krahët fort duke e afruar atë pranë vetes.

— Vërtet? — i tha lehtë ai me sy të ndezur nga dëshira për ta besuar.

— Po, — i tha ajo me ëmbëlси.

— Me gjithë zemër? — e pyeti prapë ai, pa e shkëputur nga krahët e fortë të tij.

Ajo pohoi qetas duke pulitur qepallat.

Ndërsa ai tundi lehtë kokën, si për t'i thënë: «Sa i lumtur që jam» dhe i dha gazit.

Ajo vuri buzën në gaz dhe tha ngadalë:

— Ti je një djalë interesant, Astrit.

— Pse, ç'kam unë më tepër ose më pak se shokët e mi? — tha ai qetas.

— Je i turpshëm.

— Do të thuash «një shofer i turpshëm» dhe se ky është një rast. Këtu gaboresh, Zamira. Dhe ke të drejtë ta bësh një gjë të tillë. Duhet të jetosh me shoferët që t'i njohësh më mirë nga ç'i njeh ti, e t'ua ndjesh shqetësimet... Unë disa herë jam matur të krijoja rastin të bisedoja me ty, si i thonë «me dorë në zemër», po druhesha. Mendoja se s'do ma falje guximin, se ndoshta do të thojë: «guxim prej shoferi». Por hajde. E kisha fjalën te sedra e shoferit. T'i kishe parë shokët e mi në ditët e ashpra

të dhjetorit me fytyrë të skuqur dhe me sy të për-  
lotur. E kjo, pse u ndalej maqina në rrugë nga di-  
fektet! Dhe atëhere ne i jepnim kurajë njeri-tjetrit...

— Po ty të kanë dhënë ndonjëherë kurajë sho-  
kët? — tha shpejt ajo.

Ai e largoi për pak vështrimin nga rruga dhe  
e pa pa atë drejt e në bebëzën e syrit si për t'i thënë:  
«Prapë po më ngacmon?» Po ajo po buzëqeshte  
lehtë.


— Po ja, në klub më hedhin ndonjë romuz:  
«Mbahu, Astrit, — më thonë, — se s'është e lehtë  
të marrësh një vajzë të mirë».

Ajo qeshi fort dhe pasi ngriti duart e rregulloi  
me gishta flokët, tha:

— Ç'njerëz që jeni! — dhe qeshi prapë me  
gjithë zemër.

SKICA





## SHTËPIA QË PO SHEMAJ

Në strehët prej llamarine të barrakës së vogël në hyrje të minierës pikonte një shi i imtë që i ndillte rojes gjumin e ëmbël të mesnatës. Por roja qëndronte larg sobës që kërciste nga drurët e dëllinjës dhe vështronte përjashta duke qëndruar pranë dritares. Shiu i shumtë që derdhej nga qielli pengonte dritën e llambave të vendosura gjatë rrugës.

Porta e hekurt gjëmoi dang-dang... sikur njeriu që po trokiste ta kishte dorën prej guri.

Roja rrëmbeu mushamanë, e hodhi në kokë e nxitoi të hapte derën.

Fshatari që hyri në barrakën e vogël, pas rojes, shkundi brucin e leshtë dhe largoi kapuçin nga koka.

— Nuk kam nge të flas gjatë, po bëj çmos dhe ma sill sa më parë Xhevon këtu.

Roja rrotulloi disa herë levën e telefonit manual që e lidhte me sektorin e shfrytëzimit, ngriti receptorin dhe kërkoi pompistin e turnit. Pastaj priti pak ashtu me receptorin në vesh dhe ngriti sytë për ta vështruar më mirë fshatarin.

— Pse u mundove? — e pyeti burrin e moshuar, që e kishte mbërthyer vështrimin te telefoni. Nderkaq në aparat u dëgjua zëri.



— Alo, Xhevua je? — foli roja duke afruar dorezën e telefonit më pranë veshit. — Të ka ardhur babai. Këtu. — Dhe ai ngriti sytë përsëri nga fshatari që qëndronte në këmbë, i shqetësuar, para tij.

— Për pak do ta kesh këtu, se me t'i folur unë nuk priti më, por e lëshoi përnjëherësh dorezën dhe siç duket u nis.

— Eh, — rënkoi plaku, — do të vijë se s'bën.

— I ka ndodhur gjë? — e pyeti roja me zë kureshtar.

— Lëre! Ç'e pyet...

Në rrugë u dëgjuan hapa të shpejtë dhe një llokoçitje e mbytur nëpër gropat e vogla të mbushura me ujë. Roja u ngrit hapi derën. Te kuadrati i derës qëndroi i palëvizur një burrë me shtat të lidhur me mushamanë e shkurtër supeve dhe me kapelen e minatorit në kokë.

— Fëmijët? — pyeti tërë ankth ai.

— I nxorëm.

Djali mori frymë thellë dhe lëshoi krahët poshtë si i çliruar nga diçka që pak më parë e rëndonte.

— Po ç'ka ndodhur? — pyeti prapë ai, me një zë fërgëllues, që tregonte se ende s'e kishte marrë veten mirë.

— Shtëpia...

— U shemb?

— Është gati — e plakun e ngacmoi kolla.

Djali i gozhduar në prakun e derës s'ja shqiste sytë plakut. Përjashta shiu vazhdonte punën e tij. Piklat që binin nga strehët kërcenin prakun e drunj-të të derës së hapur përgjysmë dhe binin mbi dërrasën e dyshemesë.

— Është shembur toka, lart, te Kodra e shqopës. Dheu i qullur nga shirat ka rrëshqitur, ka marrë me vete pemët që ka gjetur përpara dhe është përplasur te muri i pasmë i shtëpisë, — vazhdoi plakun.

Djali ngriti dorën dhe me gishtin e madh e tregues shtrëngoi fort mjekrën, i uli sytë dhe solli ndër mend diçka që s'po mund t'i jepte rrugë.

«Sapo t'i zë në gojë shtëpinë — kishte menduar duke kaluar nëpër pyll, — do të niset me një frymë. E di ai se ç'do të thotë të ngresh shtëpi më këmbë. Vetë ja hyri valles dhe vetë ja doli në krye. E kush do ta ndihmonte. Unë që mezi po i ngrys ditët, gruaja që lodhet në arat e kooperativës, apo fëmijët e vegjël. Po e ndihmuan dhe shokët e punës! Si jo, e ndihmuan. Po pse ai s'u ka dhënë ndihmë kur kanë pasur ndonjë hall. Pastaj përse janë shokë!» Dhe plakut i kishte ardhur mirë kur qe kujtuar për shokët e djalit. Sapo t'u thoshte Xhevu lajmin, priti kur të shkulen. Do të lënë punën! Do ta lënë që ç'ke me të. Puna e shtetit s'ka të mbaruar. Atje ka qenë me vite dhe ja tek është prapë. Po shtëpinë e re që po na e merr lumi. Hajde, Xhevo, ti para, shokët prapa dhe o burra t'i kthejmë udhën baltovinës, se puna e shtetit s'ka të mbaruar. . .

«Po tani, — mendoj plakut dhe u ul rëndë në stolin që kishte pranë, — ç'i thotë mendja, që s'po shkon të lajmërojë shokët!? Ndoshta i vjen rëndë, se kushedi ndonjë e vështron shtrembër; se s'është dhe shaka. Në këtë dimër, mes baltovinës që bën sa bën e rrëshqet përpara. . . Po në dreq të vejë ai që s'ja mban, se sonte tregohet kush të ka shok me shpirt dhe kush të lëpihet». Dhe plakut s'ju durua:

— Po dheu vjen duke u shtuar, ore Xhevo!

Djali përsëri shtrëngoi fort mjekrën me të dy gishtat dhe e shpuri mendjen sa te shtëpia dhe te galeria. «Dreq o punë, — hëngri inat me vete, — të vjen e keqja kur s'e pret. Po fundja të kishte ardhur pak më vonë, e atëhere, o burra, e te shtëpia. Po tani. . .»

— Po pas dy-tri orësh ose dhe më pak, — ngu-

li këmbë plaku, — dhe mund të marrë përpara shtëpinë siç mori edhe pemët.

Djali filloi të fërkonte ngadalë mjekrën me dorën e ngritur dhe u mundua të përfytyronte rrezikun e madh që i kanosej shtëpisë. «Po shokët e turnit!» — mendoi njëherësh dhe i erdhi inat me pompat që kishin heshtur së punuari. Po ata ashtu e kanë. Punojnë, prishen, rregullohen e prapë punojnë. Shokët e tij shponin mineralin me barominë, shpërthenin minat... Kurse ai përgjigjej për pompat, që ato të punonin në rregull e galeritë të mos mbusheshin me ujë. Dhe i erdhi të hante veten me dhëmbë që pompat kishin ngecur. «T'i kisha kontrolluar dy herë, kur mora turnin» — mendoi.

— Ore Xhevo, dëgjon ti apo jo! Dheu të ka ardhur deri te dritaret e poshtme dhe tani mund të jetë futur brenda.

— Baba! — thirri djali i hutuar dhe po në atë çast s'diti ç'të thoshte.

— Hë, ore Xhevo, se t'u trash gjuha, — e shtyu plaku.

Djali kafshoi buzën dhe ngriti sytë i menduar.

«Mirë që paskan shpëtuar fëmijët dhe gruaja, — mendoi, — se pastaj ç'do të ishte. Po dhe shtëpia s'është shaka. Lëre sa na shkoi, po dhe na telendisi se e ngritëm» — dhe u mat t'i thoshte plakut të priste sa të lajmëronte shokët. Ai përsëri mendoi: «Hajde se po u them të ngjiten, po uji pastaj, uji që mund të shembë galerinë». Dhe djali prapë u step e s'guxoi të fliste.

Ndërkohë roja vështronte herë djalin e herë plakun. Po më tepër habitej me djalin. Ç'kishte ai kështu! Ai e njihte për djalë të shkathët e punëtor të zotin. Jo më kot i kishin ngarkuar sektorin e

pompave që ishte aq delikat. Po ç'të kishte atëhere?! Nuk i dhimbsej shtëpia? Apo u mjaftua vetëm me gruan dhe fëmijët!?

— Si të ta them, baba, — foli djali me zë të dridhur, — në sektor ka avari. Pompat ka ca kohë që s'punojnë. Në galeri është ndaluar puna për shkak të ujit. Më keq e kanë ata të puseve. Atje ujët vjen duke u shtuar dhe minatorët s'janë ngjitur lart me shpresë se unë do ta gjej shpejt difektin dhe do t'i vë prapë në punë.

— Po shko e u thuaj të ngjiten, — tha shpejt plaku prerë. — Ç'e gjeti shtetin që mbeti sektori ca orë pa punë! — dhe plakut i erdhi mirë që djali po e dëgjonte me vëmendje. — Të mbenë kockat në minierë, ore i uruar. Puno me orar e puno pa orar! Prishen pompat, o burra, ti shkulesh nga shtëpia goftë natë a ditë dhe vjen këtu e ndihmon shokun derisa ropatesh. S'e kisha pasur keq atëhere kur u hap miniera. Të kujtohet ç'të pata thënë? Ç'të duhet puna e botës, shiko punën tënde që e ke në derë të shtëpisë. Po ti me tënden. Njerëzit me mend natën mblidhen në shtëpi pranë gruas e fëmijëve. Kurse ti e gdhin në turne pranë pompave. Po hajde, ç'duhen fjalët tani. Vetë e nise, vetë bitise, po shtëpisë si do t'ja bësh? Deri në mëngjes e keqja e ka bërë të sajën. Pastaj hajde vetëm për të parë!

Djali uli ngadalë kokën, si për të përfytyruar më qartë skenën që po i ndërtonin fjalët e fundit të babait. Shtëpia i therte në zemër. Po të ishte problem vetëm dalja e shokëve nga miniera dhe ndërprerja e punës për ca orë, atëhere dëshira e babait mund të plotësohej. Po galeria?! Djali largoi dorën nga mjekra dhe e lëshoi poshtë si tjetrën:

— Baba! — tha ai me dhimbje, — shpejto e zgjo

bashkëfshatarët! Ata me siguri do të të ndihmojnë.

— Po pse kuvendon kështu, ore Xhevo, — tha plaku me pikëllim. — Ata tani do të jenë duke punuar, po ndryshe është të jesh dhe ti në ballë të tyre, — tha plaku që, sipër kokës së djalit, hodhi sytë nga dera e hapur duke u munduar të shihte diçka përmes shiut. Por s'mundi dhe e ktheu vështrimin te pjata e bardhë e llambës. — Mirë, o Xhevo, po shkoj. Të bëhet si është e thëna, — dhe plaku uli sytë, shtrëngoi nofullat e vuri dorën mbi fytyrë, si për të përtypur me zor hidhërimin që ndjeu. — Po s'është mirë de, dhe kështu. Të lësh shtëpinë tënde në duar të botës. E ç'do të thonë fshatarët atje? Do të hapin synë rreth e rrotull të të veshtrajnë... — Dhe plaku mori frymë thellë. — Po pse, e lehtë është të punosh sonte në këtë shëndre. E kur s'i dhimbset të zotit, pse t'u dhimbset më shumë të tjerëve!

Djali u mat t'i thoshte: «e po hajde atëhere...», po e përmbajti veten dhe e pa të atin drejt e në bebëzat e syve, si për t'i thënë: galeria, baba, galeria...» Pastaj lëvizi sytë majtas e djathtas po s'që në gjendje të merrte vendim.

— S'më shqiten nga mendja gruaja dhe fëmijët që i lashë duke qarë në dyer të botës, — tha plaku me qëllim dhe eci përpara.

Djali kafshoi fort buzën dhe me mundim i lironi rrugën plakut që doli përjashta kokëzbuluar dhe nisi të ecte i menduar përmes shiut.

Djali nuk lëvizi nga vendi. E ndoqi të atin me vështrim të etur derisa i humbi nga sytë. Pastaj u kthye dhe pa e vënë re rojen, që kishte dalë te dera e barrakës, vrapoi përmes gropave të vogla me ujë shiu në drejtim të galerisë.



## NËPËR UDHË...

U zgjuam herët. U ngritëm nga shtrati i ngroh-të dhe u përgatitëm për udhëtim.

— Maqina është gati? — pyeti Abdullahi, përgjegjësi i grupit.

— Rakipin e ngrita të parin. Ka shkuar te maqina.

— Mos nuk i ndizet nga të ftohtët!

— U ndez, u ndez. Ja dëgjova krakaritjen motorit, — foli përsëri ai që na zgjoi.

Të përgatitur, siç ishim, vajtëm dhe u ulëm në dy stolat e karrocërisë të mbuluar me mushama.

— Edhe ti do të vish sot me ne? — m'u drejtua Abdullahi.

— Po, — i thashë.

— Është hera e parë që nisesh për një udhëtim të tillë, apo jo?

— Po, — përsërita.

— Nuk është dhe aq e lehtë.

— E di.

— Ecë dhe hip përpara!

— Jo, — kundërshtova, — do të qëndroj këtu me ju.

— Nisemi, Rakip!

Dhe u nisëm.

Vesonte një shi i hollë... Në fillim të ftohtët nuk e ndjemë, por pastaj ai filloi të na futej nëpër trup. Të ftohtët e ndjenim kudo: në xhepet ku mbanim duart, nën mëngët, nën këmbët e pantallonave dhe në këpucët e rënda.

Maqina ngjitej si me zor udhës së hapur rrëzë malit. I mbështjellë me xhup dhe me mushamanë sipër xhupit zura vend nga fundi i karrocerisë. Ajo si një dritare e madhe e hapur më jepte mundësinë të shikoja më mirë përjashta.

Maqina ngjitej e ngjitej duke gulçuar. Para syve të mi mbeteshin prapa udha që zgjatej duke dredhuar, shkëmbinj të e hirtë që mbartnin mbi shpinë përrenj të vegjël, kaçube kurrizdala, drurë të mbledhur stivë-stivë anës udhës nga fshatarët dhe shtyllat e telefonit që mbeteshin prapa si roje besnike të udhës.

Nëpër shiun e hollë ngrihej një mjegull e imtë si një vello ngjyrë manushaqe.

Maqina mori kthesën. Vështroja poshtë hidrocentralin N., i cili kishte disa orë që nuk zhurmonte dhe qytetin që mbante sipër një kapele të zbardhlyt mjegulle. I rrethuar prej kodrash të larta qyteti ngjante prej këtej me një liqen malor.

Por qyteti sot do të zgjohet me një të papritur të madhe: Nëpër dejet e disa shtëpive dhe të disa fabrikave s'do të rrjedhë ujë. Diku larg, thellë Malit me Gropa është çarë një nga tubacionet që furnizon qytetin.

Shiu pushoi. U futëm nëpër një pyll të dendur që kundërmonte nga një noti kërpudhash, drurësh dhe gjethesh të kalbura.

Kur dolëm nga thellësia e pyllit, nëpër mushamanë e maqinës na u përplas një erë e ftohtë që paralajmëronte se po hynim në zonën e dëborës. Të ftohtët filloi të na shponte trupin. U ngritëm dhe përplasëm ca këmbët. Maqina shkante ngadalë. Në këmbë siç ishim afruam fytyrat pranë dritares së vogël dhe, deri ku na mbërrinte rrezja e vështrimit, s'pamë gjë tjetër veç bardhësisë. Dëbora shtrihëj udhës, arave, kodrave dhe degëve të drurëve. Një mjegull që sa vinte bëhej më e dendur, e mbësh-tillte këtë bardhësi me vellon e saj të përhimtë. Ne, të heshtur, shkëmbyem vështrimet dhe u ulëm për-sëri nëpër stola.

— I morëm të gjitha ç'na duheshin? — pyeti Abdullahi, pa ju drejtuar ndonjërit nga ne.

— Të gjitha — u përgjegj Thomai duke vazh-duar ta mbante vështrimin përpara.

— Dhe elektrodën?

— Dhe elektrodën.

— Dhe kabllin?

— Po.

Përsëri në karrocëri ra heshtja.

Ndërkaq isha kthyer nga ata dhe i vështroja me radhë. S'ishte e lehtë të gjeje diçka karakteris-tike që të ishte e përbashkët për të gjithë! Abdu-llai është i moshuar, ka flokë të thinjur por të den-dur, ballë të gjerë dhe fytyrë burrërore, është njeri i matur dhe mjeshtër i repartit mekanik. Thomai, është një djalosh shëndetplotë, me flokë të zinj, me sy të mëdhenj me vetulla kaleshe, që e tregojnë fytyrën e tij të ngrysur; ka gjymtyrë të gjatë, është i ngathët në lëvizje, por shumë i zoti në profesion dhe sidomos për saldime. Në punë e duan të gjithë,

jo vetëm se zotëron zanatin, por dhe sepse ka shumë humor. Llambi vjen i imtë si nga fytyra dhe nga trupi, është fjalëpak. Ka diçka në karakterin e tij që të bën ta zësh shok menjëherë dhe pastaj ta duash si vëllanë. Ai ka ardhur në central bashkë me Thomain pa i mbushur të pesëmbëdhjetat dhe është rritur bashkë me të midis punëtorëve dhe inxhinierëve të zot, pranë pajisjeve të centralit dhe zhurmës së turbinave... Tani të tre mundohen të përmbajnë shqetësimin që i ka kapur nga dëborat e madhe e sidomos nga mjegulla.

— Po portat e ujit në sektor, a do t'i kenë mbyllur? — pyeti Abdullahi, si të donte ta largonte për pak shqetësimin që i kishte pushtuar.

— I kanë mbyllur.

— Qenke i sigurt!?

— Na siguroi roja e sektorit në telefon.

— Ashtu duhet të jetë. Pyeta sa për të hequr merakun. — Dhe Abdullahi nxori paqetën e cigareve e na e afroi me radhë. Unë s'desha.

— Ngaqë e kam pirë gjithë jetën, më duket se e pinë të gjithë, — tha Abdullahi, i cili e dinte që s'e pija. — Po prapë, merre një, se nuk helmohesh.

Zgjata dorën dhe e mora. Ai ma ndezi të parit me çakmakun e tij, sikur ta hante merakun se mund të pendohesha. «Pse e bëri këtë? — pyeta veten. — Ndoshta për të më bërë të merresha me diçka, apo për të më dhënë zemër?!»

— Qenka e fortë puna këtë herë! — tha Thomai.

— E fortë, po do ta kalojmë. S'do të jemi vetëm, — tha Abdullahi duke tymosur cigaren i menduar.

— Vërtet, a do takohemi shpejt me malësorët?  
— tha prapë Thomai.

— Kushedi! Në qoftë se janë nisur para nesh mund t'i takojmë shpejt. Po në qoftë se janë vonuar...

Prapë heshtje. Dëgjohej vetëm fishkëllima e erës që grindej me uturimën e motorit, që ashtu të përzjera përhapeshin gjer larg. Era nisi ta rrihte fort mushamanë e maqinës, si me kamzhik.

U ngritëm të katër më këmbë dhe tretëm vështrimet përmes dritares së kabinës nëpër mjegull, derisa maqina ndaloi në vendin ku do të merrnim udhën më këmbë.

Lamë Rakipin pranë maqinës. Ai donte të vinte me ne, po pastaj u bind se duhej të qëndronte. Zbritëm saldatriçen nga maqina e i vumë supet nën të dy drurët që i përgatitëm për të lehtësuar peshën e rëndë të hekurit dhe u nisëm më këmbë nëpër shtigjet malore që Abdullai i njihte mirë. Ecnim pa nxjerrë zë. Shkelnim mbi dëborën e ngrirë nga era, që nën peshën e këpucëve tona të rënda kërciste me atë krap-krupin e saj të thatë. Era që na rrihte përballë nisi të shtohet. Drurët përreth nën pushtetin e saj fishkëllenin fort. Ecnim. Kisha vendosur të tregohesha i fortë si shokët. Gishtat e këmbëve s'i ndjeja, vetëm nganjëherë më jepnin një dhimbje therëse. Lëkura e fytyrës nisi të më trashej. Po unë vazhdoja të ecja si shokët. Me sa duket tubacioni i çarë ishte ende larg.

Po i ngjiteshim së përpjetës nëpër një brinjë mali. Era vazhdonte të ulërinte. Nga mjegulla e dendur që na ndiqte përherë, rrezja e vështrimit na u shkurtua shumë. Mbi qilimin e bardhë të dëborës

mбетешин gjurmët e përhimta që ne i linim vazhdimisht prapa. Ecnim pranë njëri-tjetrit me një hap të rregullt duke lënë një vrage të përbashkët. Nga larg ndoshta dukeshim si një majë e errët vigane. E kush mund të na shihte!? Rrallë mund të takoje ndonjë qenje në këtë shkretëtirë të bardhë e të ftohtë. Vetëm qielli i përhimtë që lart na hidhte vështrimin e tij të ftohtë.

Vazhdonim t'i ngjiteshim brinjës së malit. Sal-datrici ja na rëndonte mjaft mbi supe. Më shumë peshën e saj e ndjenim unë dhe Llambi, që ecnim prapa. Supi më vritej nga druri, po unë vazhdoja të ecja pa pyetur për të. I kërrusur siç isha ngrita vështrimin të hetoja shokët. Ndër ta unë isha më i kërrusuri. Dhe kjo ngaqë përpara kisha Thomain shtatlartë. Me trupin e tij të fuqishëm ai dukej sikur s'e përfillte peshën që mbante. Krahëqafë ai mbante një mavzer gjerman.

Në krah të tij ecte Abdullahi. Frymëmarrja i ngrinte dhe i ulte krahërorin më shpesh se zakonisht. Nga gryka i gulçonte herë pas here një kollë e lehtë. Ky udhëtim mund të ishte për të i fundit. Moshë e tij e kishte arritur atë të pensionistit. Së shpejti ai do të ndahej nga kolektivi. Mua s'më vinte mirë kur e kujtoja këtë. Ka qenë babaxhan njeri. Llambi që ecte në krahun tim mundohej ta mposhte lodhjen. Dhe ai mbante në krah një mavzer.

Po ngjitnim ca shkallare të hapura nga malësorët e këtyre anëve. Nga e majta kishim faqen e pjerrët të malit. Nga e djathta poshtë, një rrëpirë që humbiste thellë nëpër hon. Instinktivisht trupin e anuam majtas. Vështrimet i kishim ngulur përpara. Era çamarroke frynte dhe na hidhte nga dru-

rët e faqes së malit një stuhi çërkash dëbore. Nëpër hekurin e saldatriçes dhe grykat e pushkëve ajo fishkëllente si me flautë një melodi të egër.

Mbërritëm në majën ku mjegulla dukej sikur zvarrisej poshtë, si një ushtri e bardhë e mundur. Era këtu ishte edhe më e egër. Ajo na përplaste fytyrës grimca të ngrira dëbore, që ngjanin si një breshër kokërrmadh.

Qëndruam pak. U ulëm mbi dëborë. Prapë cigare. Këtë radhë e mora vetë. Abdullahi më ra kraheve miqësisht.

— Ka qenë sportist i mirë, — shpjegoi Thomai.

— E kam parë.

U habita. Mund të kisha menduar që Abdullahi e dinte se isha marrë me sport, po s'më kishte shkuar ndër mend se mund të më kishte parë në ndeshje.

— Ka qenë i fortë, — shtoi Thomai.

— I shkathët, — nënqeshi Abdullahi duke e mposhtur me zor lodhjen.

— I shkathët dhe i fortë, — nguli këmbë Thomai.

— Ta thotë vetë, — tha ngadalë Abdullahi.

S'munda të përgjigjesha shpejt. Se si më vinte që Abdullahi donte të më hiqte një rën nga cilësitë që unë e kisha treguar në të gjitha ndeshjet. «Po Llambi pse s'flet» — mendova. Por atij si përherë ja kishte qejfi vetëm të dëgjonte. «Po Abdullahi, përse ngul këmbë, — mendova prapë — nuk ka besim te unë?! Kushedi...»

— Në cilën ndeshje me kishte parë? — thashë unë.

Ai e kapi shpejt domethënjen e pyetjes sime

dhe më ra krahëve, si për të më thënë: «hajde, hajde, se të kam parë...»

U ngritëm, ndërruam krahun dhe u nisëm përsëri për udhë. Po zbrisnim nëpër ca shkallare të veshura me akull. Përsëri trupin anash. Nga buzët s'nxirrnim asnjë fjalë. Vetëm fryma që më dilte nga goja si avull më ngrohte pak mollëzat dhe qepallat. Zbrisnim me vështrim të ulur, hetoja hapat që hidhnin dy shokët që ishin përpara. Ndoqa një farë kohe me sy Thomain. Ai hidhte, i sigurt, këmbët përpara. Pastaj ndoqa hapat e Abdullait. Atij i ka qëlluar keq. Pesha më e madhe e saldatricës i rëndon mbi supin e djathtë. Dhe kjo se në krah ka Thomain truplartë. Ndaj ecën i kërrusur dhe i ka vënë të dyja pëllëmbët e duarve për të mbajtur drurin në vendin ku i prek supin. Trupin e kishte anuar nga faqja e malit për t'ju shmangur buzës së honit. Frymëmarrja vazhdonte t'ja ulte dhe t'ja ngrinte kraharorin me një ritëm të çrregullt. Hetoja pa i hequr sytë nga këmbët e tij që mundoheshin të ecnin me ritmin e Thomait. Diç ndjeva për të. Mendova t'u propozoja shokëve për pak pushim. Por s'arrita. Më mbeti vetëm të përkulesha thellë në gjunjë, të mbërtheja mirë Llambin prej rripit të pushkës dhe të lëshoja një britmë: «Abdulla!»

Po Abdullai s'mundi ta dëgjonte britmën time. Kishte rrëshqitur nga buza e greminës duke na lënë së të ngrirë.

E ulëm me ngadalë dhe me shumë kujdes saldatricën dhe ju afruam buzës së greminës, vumë pëllëmbët pranë buzëve dhe të merakosur thirrëm njëherësh:

— Abdulla! Abdulla! Abdullaaa...

Po s'morëm asnjë përgjigje. Unë vura fytyrën



mbi pëllëmbët e hapura dhe shtrëngova fort tëmthin me gishtin e madh.

Pastaj, si të ngritur nga një gjumë i rëndë dhe i hidhur, u vështruam në sy sikur të kërkonim diçka, ndoshta për të marrë zemër nga njëri-tjetri.

— Unë e kisha fajin, — rënkoi Thomai. — Unë s'duhej ta kisha lënë në anën e greminës, — dhe i përplasi fort pëllëmbët me gishtat e hapur mu para syve.

Ne me Llambin s'pipëtimë. Mua ende s'më dilte nga mendja çasti i rënjes së Abdullait, ndërsa më ushtonte në vesh thirrja e dhembshur e tij.

— Të zbresim, të zbresim shpejt, — thirri Llambi, si i zgjuar nga një ëndërr e llahtarshme.

— Jo, — tha prerë Thomai. — Ju të dy kaloni përpara me saldatricën. Unë do të pres këtu sa të largohet dhe pak mjegulla.

Ne as qepallat s'lëvizëm. Vështrimi ynë u kryqëzua dhe u ndesh me atë të Thomait. Vështrimi i tij u mund nga yni.

— Po qyteti do ujë. Fëmijët duan ujë. Të sëmurët duan ujë. Shokët tanë punëtorë duan ujë. Ju të dy mundet dhe duhet t'u dërgoni ujin. — Dhe Thomai mori frymë thellë. — Ecni! Shkoni përpara! Të dy jeni të fortë. Më pas do të vij unë me Abdullain. Unë do ta nxjerr Abdullain. Morët vesh? Do ta nxjerr. Ndoshta nuk ka pësuar ndonjë gjë me rëndësi. . .

Zëri i tij i fortë por i veshur, urdhërues dhe lutës na u fut nëpër trup, na ngrohu në shpirt dhe pastaj oshëtiu tejpertej grykës nga po zbrisnim, bëri poshtë andej nga kishte rënë Abdullai.

— Jo, — thirrëm të dy njëherësh si për të leh-

tësuar dhembjen. — Abdullahi nuk duhet të ketë pësuar gjë me rëndësi.

Ai na vështroi dhe sytë ju ndezën.

— Kabllon, shpejt kabllon! — thirri.

Llambi i doli përpara.

— Ti duhet të jesh sa më shpejt pranë tubacionit, — i tha i vendosur.

— Dhe ti saldon, — u justifikua Thomai.

— Atëhere më përket mua, — thashë i rrëmbyer nga dëshira për të shpëtuar Abdullahin. — Jam dhe i shkathët, — dhe rrëmbeva kabllon që ishte sipër saldatriçes, e mbështolla dy-tri herë për mesi dhe thirra: — Hajde pra, ç'prisni! Lëshomëni!

S'patën kohë të më kundërshtonin. Hoqën dorëzat, e mbërthyen kabllon me duart e tyre të fuqishme dhe filluan të më lëshonin poshtë me kujdes. Ngrita sytë dhe buzëqesha lehtë si për të thënë «kini besim tek unë». Ata m'u dukën si dy copa të mëdha shkëmbi të shkëputura nga faqja e malit, të mbetura ashtu rrëzë shkallareve, që s'kishte ç't'u bënte më as era dhe as murlani. Më buzëqeshën për të më dhënë zemër. . .

Zbres përherë e më me kujdes duke mbështetur tabanet e këmbëve në shtegun që ka hapur trupi i Abdullahit nëpër dëborën e fortë që ka veshur faqen e pjerrët të honit. Kam një dëshirë të papërmbajtur të ndeshem sa më shpejt me Abdullahin.

I jam afruar fundit të honit dhe thërres Abdullahin, sikur të isha i bindur që po më priste. Dhe vërtet dëgjova përgjigjen e tij.

— Si ndjehesh? — i them sapo ju gjenda pranë.

— Si njeriu që është i sigurt për ndihmën e shokëve, — dhe më bëri shenjë me dorë që t'i shtren-

goja fort nyjen e këmbës së djathtë me shallin e tij.

— Pse s'u përgjigje kur të thirrëm?

— Ndoshta do të kem qenë i trullësuar.

Hodha sytë përçark. Heshtje e bardhë, vazhonte të binte dëborë. Çova kokën e pashë vendin nga kisha zbritur. Lartësi që bien thikë. Dhe nga krahu tjetër lartësi shkëmbore mbuluar nga akulli dhe dëbora. «Ka shpëtuar për mrekulli,» — mendova për Abdullain dhe ju ktheva prapë atij:

— Do vinte Thomai, po unë nuk e lashë, — i fola ngadalë duke hequr shallin tim për t'i shtrënguar nyjen e këmbës së enjtur. Unë e kisha më të lehtë për të zbritur — thashë dhe i shtrëngova fort këmbën. Tani ai duhej të ndjente dhembje, por s'e jepte veten. Më ra lehtë krahëve dhe qeshi me nai-vitetin tim duke më thënë:

— Në detyrë të rinj e të vjetër jemi njëloj.

— Vërtet, — thashë unë — ata lart duhet të jenë shumë të merakosur — dhe tunda disa herë kabllon, duke menduar se kjo do të qe një shenjë e mirë për ta.

Ai tundi kokën e tha:

— S'na gjen gjë neve, të moshuarve, jo.

Nga mënyra se si foli e kuptova se dhe Abdullai ishte i gëzuar që kishte shpëtuar mirë.

— Të kishim pritur dhe ca sa të hapej koha, pastaj të ishim nisur, — i thashë duke dashur t'i kujtoja nisjen e shpejtë të grupit.

— Ashtu është, po ama puna e ujit s'pret.

— Mua më ka zënë belaja me shokët, — thashë unë duke dashur ta zgjasja dhe pak bisedën që Abdullai ta merrte veten më mirë. «Qëkur ke

filluar punën ti në hidrocentral — më thonë — ke nisur të na lësh pa ujë».

Përsëri ai vuri buzën në gaz me shakanë e shokëve të mi dhe deshi të thoshte diçka. Po kabllaja u tund disa herë.

Abdullahi ngriti sytë dhe u mundua të ngrihej.

— Vërtet, — thashë unë duke e ndihmuar të ngrihej, — në cilën ndeshje më ke parë?

Ai tundi lehtë kokën.

— Të janë mbushur ndonjëherë sytë me lot pas ndeshjes? — pyeti ai.

— Po, — thashë unë, — vetëm një herë.

— Po njerëzit e fortë s'duhet të qajnë, — tha prapë ai.

— Atëhere isha i ri dhe më erdhi të pëlçisja që ma humbën ndeshjen padrejtësisht.

— Të fortëve u shkon më për shtat burrëria. Ja sot e tregove veten të tillë. Po hajde, se po bëhem i vonë për të ndrequr avarinë, — tha dhe e shtrëngoi fort kabllon për mesin...

\* \* \*

Dëborë nisi të binte me pllazë më të mëdha. Ne vazhdonim të ecim përpara pa pyetur për ulërimën e erës dhe ungërimën e mbytur e të largët të ujëve. S'ishim më katër vetë. Me ne u bashkuan dhe malësorët e zonës që kishin ardhur për ndihmë. Vetëm Abdullahi ecte kaluar. Malësorët, mbasi shprehën keqardhjen që s'na kishin dalë përpara më shpejt, na u lutën t'u hipnim kuajve të tyre. Ne të tjerët s'pranuam. Saldatriçen e lidhëm fort në sha-

lën e një kali të fuqishëm. E mbuluar e gjitha nga flokët e dëborës, ajo ngjante me një nuse që kishte hedhur në kokë vellon e bardhë. Sikur të qe qielli i hapur dhe dielli të regëtinte me rrezet e tij të praruar, velloja do të shëndriste me një refleks të ëmbël argjendi. Po qielli vazhdonte të ishte i ngrysur në këtë ditë të ashpër dimri.

Ecëm dhe pak dhe më në fund arritëm në vendin ku ishte çarë tubacioni. Ja nisëm menjëherë punës. Mbas pesë orë përpjekjesh të pandërprera për saldimin e sigurt të tubacionit, Abdullai urdhëroi të hapeshin portat e hekurta të sektorit. Uji u lëshua rrëmbimthi me gurgullimë nëpër tubacionin e madh. U përqaftuam me njëri-tjetrin.

— Megjithatë, — tha Abdullai duke më rënë krahëve, — gruaja dhe fëmijët e mi do ankohen që mbetën ca orë pa ujë.

— Ndërsa shokët e mi do të vazhdojnë të ma hedhin fajin mua, — qesha unë dhe përbrenda më pushtoi një ndjenjë e dyfishtë gëzimi dhe krenarie: — Edhe unë isha bërë bashkëudhëtar me anëtarët e këtij grupi të vogël, që përveç punës si remontierë në hidrocentral ishin kurdoherë të gatshëm që me sinjalin e parë të niseshin për të zhdukur shpejt të gjitha avaritë.

## PASQYRA E LËNDËS

### *T r e g i m e*

Faqe

Rrethimi. ....	5
Një ditë para se të çlirohej qyteti .....	26
Kur buzëqeshte beu .....	39
Mbrëmje e shqetësuar .....	51
Elektriciisti i turnit .....	60
Ajo qeshi me gjithë zemër .....	71

### *S k i c a*

Shtëpia që po shembej .....	85
Nëpër udhë .....	95